



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr.66, datë 28.07.2005**

**PËR  
MIRATIMIN E DEKLARATËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË  
“MBI ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E  
PARË TË VITIT 2005 ”**

1.

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë deklaratën e Bankës së Shqipërisë “**MBI ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2005**”, sipas teksit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e kësaj deklaratë në Kuvendin e Shqipërisë, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**

**BANKA E SHQIPËRISË**

**DEKLARATA GJASHTËMUJORE**

**E**

**ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE**

**JANAR – QERSHOR 2005**

**KORRIK 2005**

## **PËRMBAJTJA**

<b>I.</b>	<b>Fjala e Guvernatorit</b>	<b>4</b>
<b>II.</b>	<b>Ecuria ekonomike gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005</b>	<b>7</b>
II.1	Ekonomia botërore	7
II.2	Ekonomia shqiptare gjatë gjashtëmuajorit të parë	8
II.2.1	Ecuria e prodhimit sipas sektorëve të ekonomisë	8
II.2.2	Tregu i punës	12
II.2.3	Sektori fiskal	12
II.2.4	Sektori i jashtëm	15
II.3	Ecuria e inflacionit gjatë gjashtëmuajorit të parë	17
II.3.1	Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse	18
II.3.2	Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit	21
<b>III.</b>	<b>Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare</b>	<b>26</b>
III.1	Politika monetare e Bankës së Shqipërisë	26
III.2	Ecuria e agregatëve monetarë	27
III.3	Kërkesa e brendshme	30
III.3.1	Mjetet valutore neto	30
III.3.2	Kërkesa e qeverisë për mjete monetare	31
III.3.3	Kredia për ekonominë	32
III.4	Tregjet financiare dhe ecuria e normave të interesit	34
III.4.1	Ecuria e likuiditetit	34
III.4.2	Ecuria e normave të interesit	36
III.5	Ecuria e kursit të kembimit	39
IV.	Ecuria ekonomike gjatë vitit 2005	40

## I. FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare është karakterizuar në përgjithësi nga një ecuri e mirë dhe brenda parametrave të pritur, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005. Aktiviteti ekonomik në Shqipëri ka marrë jetë në kushtet e një përmirësimi të lehtë të ekonomisë në nivel botëror. Ekonomia botërore ka vazhduar të rritet me një ritëm të moderuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. Ekonomia amerikane ka qenë një nga forcat kryesore shtytëse të aktivitetit ekonomik botëror, ndërsa situata ekonomike në Eurozonë dhe në Japoni, ndonëse në përmirësim, vazhdon të mbetet e brishtë. Rritja e ekonomisë botërore është shoqëruar me rritje të vëllimit të shkëmbimeve tregtare. Nga ana tjetër, zhvillimet jo të favorshme në çmimet e naftës dhe pasiguria e lidhur me kursin e këmbimit, nuk janë përcjellë në të gjithë amplitudën e tyre në ekonominë e brendshme.

Duke gjykuar nga zhvillimet e sektorëve të veçantë, nga ecuria e treguesve fiskalë si dhe nga rritja e shpejtë e kredisë për ekonominë, mund të thuhet se kjo periudhë ka qenë e favorshme për ekonominë e vendit dhe për realizimin e objektivave të zhvillimit. Në përgjithësi, sektorët më vitalë të ekonomisë shqiptare, gjatë fillimit të vitit 2005, kanë regjistruar ecuri të kënaqshme në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Normat e rritjes vjetore të tyre kanë ardhur në rritje, duke dëshmuar për një trend afatgjatë në rritje të zhvillimit të ekonomisë. Sektorët që kanë shënuar rritje më të larta në bazë vjetore të shitjeve janë ndërtimi, tregtia, shërbimet, bujqësia dhe agroindustria, ndërkohë që sektori i transportit dhe i industrisë kanë realizuar vëllime pothuajse të njëjta shitjesh me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Ecuria pozitive e aktivitetit ekonomik në vend është shoqëruar me përmirësimin e mëtejshëm të situatës në tregun e punës. Ky përmirësim është manifestuar në rritjen e numrit të të punësuarve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe në rënien e normës së papunësisë në tremujorin e parë të vitit 2005. Norma e papunësisë e tremujorit të parë të këtij viti ka shënuar vlerën më të ulët të 7 viteve të fundit.

Llogaria korente, gjatë periudhës janar-mars të këtij viti, rezultoi me një deficit prej 56.2 milionë usd duke shënuar një përkeqësim të lehtë ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ndërkohë që ritmet e rritjes së importeve dhe të eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve kanë qenë të përafërta, vëllimi i madh i importeve ka rezultuar në thellim të deficitit korent. Deficiti tregtar prej 363 milionë usd si edhe deficiti prej rreth 40 milionë usd në kategorinë e shërbimeve është mbuluar në pjesën më të madhe nga flukset hyrëse të transfertave korente, kryesisht private. Flukset hyrëse të kapitalit, gjatë tremujorit të parë, kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar deficitin korent, duke rezultuar në një nivel pozitiv të bilancit të përgjithshëm të pagesave prej afërsisht 13 milionë usd. Mbiçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan dhe ndaj euros ka ulur çmimin e mallrave dhe të shërbimeve të huaja, ndërkohë që ky mbiçmim nuk ka cënuar konkurrueshmërinë e eksporteve tona, si pasojë e strukturës së këtyre të fundit të orientuara drejt rieksperteve.

Megjithë fushatën zgjedhore të vitit 2005, Banka e Shqipërisë vlerëson se situata fiskale ka qenë nën kontroll. Zhvillimet fiskale, gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, kanë qenë të moderuara dhe treguesit nuk e kanë kaluar nivelin e parashikuar për këtë periudhë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit qershor janë mbledhur 98.3 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe është realizuar rreth 97.7 për qind e shpenzimeve të programuara. Për pasojë, deficiti buxhetor në fund të muajit qershor ka shënuar rreth 9.4 miliardë nga 10.2 miliardë lekë të

parashikuara. Deficiti buxhetor për këtë periudhë, është financuar kryesisht me burime të brendshme, ndërkohë që financimi i huaj ishte rreth 50 për qind e shumës së parashikuar.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2005 është karakterizuar nga norma të ulëta inflacioni. Inflacioni vjetor ka patur një tendencë rënëse gjatë pjesës së parë të vitit, duke arritur vlerën 1.3 për qind në muajin prill, ndërkohë që muajt maj dhe qershor shënuan një rritje të inflacionit deri në nivelin 2.9 për qind. Inflacioni mesatar vjetor ka qenë vazhdimisht brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë, duke u stabilizuar në vlerën 2.25 për qind, në muajin qershor. Orientimi i politikave fiskale dhe monetare drejt ruajtjes së stabilitetit makroekonomik si dhe zhvillimet pozitive në grupe të ndryshme mallrash të konsumit, brenda një mjedisi makroekonomik të përshtatshëm kanë mundësuar kontrollimin e normës së inflacionit. Bilanci i faktorëve të kërkesës dhe të ofertës nuk ka rezultuar në presione inflacioniste gjatë kësaj periudhe. Rritja modeste e pagave, rritja e çmimeve të naftës dhe rritja në çmimet e administruara, janë kompensuar nga veprimi i faktorëve disinflacionistë si niveli i qëndrueshëm i kërkesës së brendshme, situata e kontrolluar monetare, mbiçmimi i qëndrueshëm i lekut dhe rritja e prodhimit bujqësor në vend.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur përgjithësisht një kah zbutës, gjatë gjashtëmujorit të parë. Kjo tendencë ka qenë më e theksuar në tremujorin e parë, duke u finalizuar me uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit në fund të muajit mars, ndërkohë që gjatë tremujorit të dytë politika monetare ka marrë gradualisht një qëndrim neutral. Lehtësimi i politikës monetare është reflektuar në rënien e vazhdueshme të normave të interesit në tregjet financiare. Kjo ulje ka qenë më e theksuar për maturitetet afatmesme duke ndikuar në sheshimin e kurbës së normave të interesit në lekë. Politika monetare zbutëse e Bankës së Shqipërisë është pasuar nga rritja e kërkesës për mjete monetare. Burimi kryesor i zgjerimit monetar gjatë kësaj periudhe ka qenë kreditimi i ekonomisë, në ndryshim nga vitet e kaluara kur këtë funksion e ka realizuar huamarrja e qeverisë apo flukset hyrëse valutore. Teprica e kredisë është rritur mesatarisht me rreth 3.7 miliardë lekë në muaj, gjatë periudhës janar- maj 2005, duke shënuar në fund të periudhës një rritje totale prej 18.7 miliardë lekësh. Ky nivel është i njëjtë me rritjen e kredisë gjatë gjithë vitit 2004. Zhvillimet pozitive të kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e të gjithë treguesve makroekonomikë të kredisë.

Konsolidimi i vazhdueshëm i stabilitetit makroekonomik gjatë viteve të fundit, përbën një bazë të mirë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare gjatë pjesës së mbetur të vitit 2005. Ekonomia shqiptare i ka të gjitha premiset për një zhvillim brenda kornizave të programuara. Megjithë tablonë e mësipërme, relativisht optimiste, javët e fundit është konstatuar një lëvizje e forcuar e fondeve monetare nga kanalet bankare në ekonomi, si pasojë e shfaqjes më të hershme të faktorit sezonal, e pagimit të fondeve të bllokuara në firmat piramidale dhe paqartësive që në përgjithësi karakterizojnë situatën parazgjedhore dhe atë paszgjedhore. Ne jemi duke ndjekur me kujdes zhvillimet më të fundit të likuiditetit, veçanërisht ato të lidhura me financimin e deficitit buxhetor.

Në interes të garantimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë, ne besojmë se këto zhvillime do të jenë të përkohshme dhe administrimi normal i të ardhurave do të rikuperohet shumë shpejt me krijimin e ekzekutivit të ri shqiptar. Banka e Shqipërisë mbetet thellësisht e angazhuar për respektimin e treguesve programorë të zhvillimit ekonomik dhe financiar të vendit për vitin 2005 dhe, në këtë kontekst, ne shpresojmë se nuk do të mungojë edhe angazhimi i autoriteteve përkatëse. Njëkohësisht, Banka e Shqipërisë

përfiton nga rasti t'i bëjë thirrje të gjitha subjekteve ekonomike për respektimin e detyrimeve tatimore në bazë të legjislacionit dhe të rregullave në fuqi. Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë do të synojë të ruajë në ekonomi kushte monetare konsistente me objektivin e inflacionit prej 2-4 për qind, duke synuar në të njëjtën kohë zhvillimin e tregut financiar sipas modeleve më të përparuara, përmirësimin e infrastrukturës së pagesave dhe rritjen e shkallës së ndërmjetësimit financiar në ekonomi. Për realizimin e objektivave të zhvillimit të vendit, ajo vlerëson si një faktor thelbësor mbështetjen dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse në fushën e politikave ekonomike dhe ruajtjen e tempit të reformave strukturore të ekonomisë.

## II. ECURIA EKONOMIKE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2005.

### II.1 EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore ka vazhduar të rritet me një ritëm të moderuar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. Ecuria pozitive e ekonomisë amerikane ka qenë një nga forcat kryesore shtytëse të aktivitetit ekonomik botëror. Ekonomitë e Eurozonës dhe të Japonisë kanë patur një paraqitje më të mirë krahasur me periudhën e mëparshme, por situata ekonomike në këto vende vazhdon të mbetet e brishtë. Ekonomia e Kinës vazhdon të rritet me ritme të shpejta, duke nxitur aktivitetin ekonomik edhe në pjesën tjetër të Azisë Lindore. Aktiviteti ekonomik botëror për këtë fillim viti është bazuar në ecurinë pozitive të sektorit të shërbimeve në krahasim me sektorin prodhues. Në këtë asimetri ka ndikuar edhe rritja e kostove të sektorit prodhues, si efekt i rritjes së çmimit të naftës. Çmimi i lartë i naftës vazhdon të jetë një nga problemet kryesore të ekonomisë botërore.

**Tabelë 1. Disa tregues ekonomikë të gjashtëmuorit të parë të vitit 2005.**

	PBB – T1	Norma e papunësisë	IÇK
SHBA*	3.8	5.0 (qershor)	2.5 (qershor)
Eurozonë	1.3	8.8 (maj)	1.9 (maj)
Francë	1.8	10.2 (maj)	1.5 maj
Gjermani	1.1	11.7 (qershor)	1.9 qershor
Itali	-0.2	7.8 (mars)	1.8 qershor
Britani e Madhe	2.1	4.6 (mars)	1.9 (maj)
Japoni	0.8	4.4 (prill)	0.2 (maj)
Kinë	9.5	-	2.7 (mars)

Burimi: Buletini Mujor i Bankës Qendrore Evropiane dhe Eurostat.

\* Të dhënat për ekonominë amerikane janë marrë nga Departamenti Amerikan i Punës dhe nga Departamenti Amerikan i Tregtisë.

**EKONOMIA AMERIKANE.** Aktiviteti ekonomik amerikan shënoi ritme të kënaqshme rritjeje edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2005. E kthyer në bazë vjetore, norma reale e rritjes së PBB-së në tremujorin e parë ishte 3.8 përqind. Rritja e ekonomisë amerikane pasqyron rritjen e shpenzimeve konsumatore, të eksporteve dhe të investimeve. Shpenzimet konsumatore janë mbështetur nga përmirësimet në kushtet e tregut të punës si dhe nga zhvillimet pozitive të tregut të shtëpive. Duke patur parasysh rigjallërimin e presioneve inflacioniste, banka qendrore e SHBA, Federal Reserve, ka vazhduar të shtrëngojë me “hapa të matur” politikën monetare. Në mbledhjen e datës 30 qershor, FOMC-ja rriti për të nëntën herë radhazi normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 3.25 përqind.


**EKONOMIA E EUROZONËS.** Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2005 paraqiten më pozitive për ekonominë e Eurozonës. Sipas vlerësimeve të para, rritja e PBB-së të Eurozonës gjatë tremujorit të parë është 0.5 përqind, nga 0.2 përqind që ishte në tremujorin e katërt të vitit të kaluar<sup>1</sup>. Rritja e PBB-së ka ardhur si rezultat i rritjes së eksporteve, në një kohë që kërkesa e brendshme nuk ka pasur rritje, ndërsa rritja e investimeve ka qenë më e ulët se ajo e periudhës paraardhëse. Në Eurozonë, norma bazë e interesit vazhdon të jetë 2 përqind, që prej muajit qershor 2003. Normat e ulëta të interesit kanë vazhduar të kenë impakt stimulues në ekspansionin monetar dhe në kredi. Niveli i inflacionit (i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit) në muajin maj u ul në 1.9

<sup>1</sup> Specialistët e Bankës Qendrore Evropiane vlerësojnë se një pjesë e kësaj rritjeje është efekt statistikor. Vlerësohet se efekti i rregullimit sipas ditëve të punës ka ndikuar në nënvlerësim të PBB-së për tremujorin e katërt të vitit 2004 dhe në mbivlerësim për tremujorin të parë të vitit 2005.

për qind, pas një periudhe tremujore gjatë së cilës ky tregues ishte në nivelin 2.1 për qind. Gjatë kësaj periudhe, rritja e pagave ka qenë e moderuar duke mos ushtruar presione inflacioniste.

**KURSI I KËMBIMIT.** Monedha e Eurozonës është zhvlerësuar si në terma nominalë, ashtu edhe në terma realë gjatë vitit 2005. Në fillim të muajit qershor, raporti i monedhës euro kundrejt monedhave të 23 partnerëve kryesorë tregtarë kishte shënuar një ulje prej rreth 2.8 për qind kundrejt mesatares së vitit 2004. Debatet politike në lidhje me kushtetutën si dhe vota “jo” e referendumit në Francë dhe në Holandë ndikuan negativisht në ecurinë e monedhës së Eurozonës. Rritja e normave të interesit në SHBA ka bërë që investuesit të ndikohen nga *yield*-i i pritur më shumë se nga deficitet e ekonomisë amerikane.


**Grafik 1. Ecuria e kursit të këmbimit euro/usd.**



Burimi: Bloomberg.

**ÇMIMI I NAFTËS.** Çmimi i naftës ka vazhduar të rritet gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, duke kaluar edhe pikun e arritur në muajin tetor të vitit të kaluar. Në muajin prill 2005, një fuçi naftë e papërpunuar<sup>2</sup> kushtoi mbi 57 dollarë. Rritja e çmimit të naftës gjatë viteve të fundit ka ardhur si pasojë e rritjes së kërkesës dhe e shtrëngimit të ofertës për naftë, si rrjedhojë e pasigurive gjeopolitike. Kjo rritje vlerësohet se ka patur një efekt të moderuar si mbi aktivitetin ekonomik botëror, ashtu edhe mbi inflacion.

**Grafik 2. Ecuria e çmimit të naftës së papërpunuar për fuçi në dollarë amerikanë.**



Burimi: Bloomberg.com


<sup>2</sup> US light crude.



## II.2 EKONOMIA SHQIPTARE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË

Ekonomia shqiptare është karakterizuar në përgjithësi nga një ecuri e mirë dhe brenda parametrave të pritshëm gjatë gjashtëmujsorit të parë të vitit 2005. Duke gjykuar nga ecuria e shitjeve të ekonomisë, nga zhvillimet e sektorëve të veçantë, nga ecuria e treguesve fiskalë si dhe nga rritja e shpejtë e kredisë për ekonominë, mund të thuhet se kjo periudhë ka qenë e favorshme për ekonominë e vendit. Sipas të dhënave të shitjeve të përfuara nga TVSH-ja, të cilat trajtohen si indikatorë të përafërt të ecurisë së prodhimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, tremujori i parë i vitit 2005 ka shënuar rritje në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Tremujori i parë i këtij viti ka shënuar vlerën më të lartë të shitjeve për këtë tremujor gjatë katër viteve të fundit. Sektorët që kanë shënuar rritje më të larta të shitjeve, në bazë vjetore, janë 'Ndërtimi', 'Tregtia' dhe 'Shërbime të tjera', ndërkohë që sektori i transportit dhe ai i industrisë kanë realizuar vëllime pothuajse të njëjta shitjesh me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

**Grafik 3. Ecuria e shitjeve të ekonomisë gjatë periudhës T1'01-T1'05.**



Burimi: INSTAT

Të ardhurat nga TVSH shënojnë një rritje vjetore prej 8.9 për qind gjatë pesëmujsorit të parë të vitit, duke dëshmuar për një rritje të shkëmbimeve tregtare në vend. Kreditimi i ekonomisë ka shënuar një rritje vjetore prej rreth 50 për qind. Së bashku me zhvendosjen e strukturës së kredisë drejt sektorëve prodhues, ky zhvillim tregon për një shfrytëzim më të madh të potencialit financiar të vendit në drejtim të mbështetjes së nevojave të zhvillimit të vendit. Tremujori i parë i vitit ka treguar një konkurrueshmëri më të madhe të eksporteve shqiptare, e shfaqur kjo në rritjen vjetore prej 16.1 për qind të eksporteve gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, numri i të punësuarve gjithsej është rritur me 12 mijë vetë, në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2004. Duke gjykuar mbi këto të dhëna, si dhe duke marrë parasysh kufizimet që paraqesin ato për dhënien e një opinioni të qartë në lidhje me ecurinë e ekonomisë, sidomos në aspektin sasior, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare ka shfaqur shenja rritjeje gjatë kësaj periudhe. Gjithsesi, informacioni i pritur gjatë muajve në vazhdim do të na ndihmojë në krijimin e një opinioni më të qartë dhe me të saktë në lidhje me ecurinë e aktivitetit ekonomik.

### II.2.1 Ecuria e prodhimit sipas sektorëve të ekonomisë

#### DEGA E BUJQËSISË

Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, prodhimi bujqësor pritet të rritet në masën e parashikuar në fillim të vitit me 4.7 për qind. Kushtet klimaterike vlerësohen në përgjithësi të favorshme për realizimin e prodhimit të parashikuar. Pranvera e vonë ka ndikuar në futjen më

vonë se vitet e tjera të prodhimit vendas në treg, por klima e verës ka qenë e favorshme për ecurinë e prodhimit bujqësor.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005 është vënë re një rritje e sipërfaqes së mbjellë me perime, më foragjere dhe me drithëra. Sipas Vrojtimin të Agroindustrisë për tremujorin e parë të vitit 2005, prodhimi agroindustrial është rritur në total me 11 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005, në sektorin e agroindustrisë janë regjistruar rreth 40 subjekte të reja, nga të cilët 35 kanë filluar aktivitetin. Numri i të punësuarve në total në agroindustri nuk ka ndryshuar në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë.

**Tabelë 2. Ecuria e prodhimit agroindustrial gjatë tremujorit të parë 2005 (miliardë lekë).**

	T1'05	T1'05/T1'04 (në %)
<b>Prodhimi agroindustrial</b>	6.8	11
Mish dhe nënprodukte të tij	0.6	23
Produkte të konservuara	0.2	82
Qumësht dhe nënprodukte të tij	1.2	4
Miell gruri dhe buke	2.2	25
Pije	0.6	10
Ujë dhe pije freskuese	0.7	-24
Të tjera	0.7	28

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

## ENERGJITIKA

Prodhimi i energjisë elektrike ka qenë në nivele të kënaqshme gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2005. Sasia e energjisë së prodhuar gjatë kësaj periudhe ka qenë rreth 3,200 GËH ose rreth 4 për qind më e lartë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Sasia e energjisë së eksportuar gjatë kësaj periudhe është rreth 2 herë më e lartë se sasia e energjisë së eksportuar gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2004. Konsumi i konsumatorëve jofamiljarë ka shënuar një rritje me rreth 7 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që konsumi i familjarëve ka rënë me 3 për qind.

**Tabelë 3. Të dhëna për furnizimin dhe përdorimin e energjisë elektrike.**

	6 M - 2004	6 M - 2005	Ndryshimi	Përdorimi për KËH (në %) 2005
Prodhimi	3,133	3,259	4%	
Importi	314	412	31%	
Sasia e furnizuar	3,447	3,671	7%	100%
Eksporti	264	512	94%	13.95%
Humbjet	1,263	1,221	-3%	33.26%
Përdorim familjar	1,145	1,107	-3%	30.15%
Përdorim jofamiljar	765	822	7%	22.39%

Burimi: Ministria e Industrisë dhe e Energjitikës.

## TRANSPORTI

Indeksi i shitjeve në sektorin e transportit dhe të telekomunikacionit, në tremujorin e parë të këtij viti, paraqitet me një rritje prej 6.6 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Transporti detar pati një rritje prej rreth 6 për qind gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Importet në portet kryesore të vendit u rritën me 7 për qind, ndërsa eksportet, të cilat janë rreth 10 herë më të ulëta se importet, ranë me 0.4 për qind. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2005, transporti hekurudhor i mallrave shënoi një rënie prej 20 për qind, ndërsa transporti hekurudhor i pasagjerëve u ul në masën 24 për qind. Transporti ajror ka regjistruar një rritje mesatare vjetore


prej rreth 15 për qind në 10 vitet e fundit. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2005, transporti ajror ka vazhduar të rritet, gjë që është pasqyruar në rritjen me 27 për qind të numrit të fluturimeve dhe në rritjen me 22 për qind të numrit të pasagjerëve.

Investimet në sektorin e transportit gjatë gjashtëmuorit të parë të këtij viti kanë patur një rënie prej rreth 31 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies në investimet e brendshme, të cilat ishin 33 për qind më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, edhe investimet e huaja u ulën me rreth 27 për qind.

## NDËRTIMI

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, shitjet në sektorin e ndërtimit ishin rreth 34 për qind më të larta në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2004. Rritja vjetore për tremujorin e parë të këtij viti, përfaqëson një zhvillim mjaft pozitiv për sektorin e ndërtimit, sidomos duke marrë parasysh mungesën e rritjes vjetore në tremujorët e parë të dy viteve paraardhëse. Indeksi i kushtimit në ndërtim, për tremujorin e parë të këtij viti, u rrit me 3 për qind. Në këtë indeks vërehet një rritje në shpenzimet direkte totale. Zërat që kanë shënuar rritje vjetore më të lartë, përkatësisht 8.8 dhe 9.7 për qind, janë pagat dhe transporti. Gjithashtu, vërehet se fitimi i parashikuar ka patur një rënie prej 1.5 për qind duke reflektuar rritjen e kostos së ndërtimit.


**Grafik 4. Shitjet në sektorin e ndërtimit dhe rritja vjetore sipas tremujorëve.**



Burimi: INSTAT.

Investimet në sektorin e ndërtimit, si nga burimet private ashtu edhe ato shtetërore, kanë shënuar rritje gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Kështu, fondet e parashikuara për investime në tremujorin e parë të vitit, u rritën me 55 për qind. Peshën kryesore në këtë rritje e kanë pasur investimet për ndërtimet për banim, të cilat janë rritur me 30 për qind. Gjithashtu, rritje të ndjeshme kanë shënuar edhe ndërtimet inxhinierike. Numri i lejeve të ndërtimit është rritur mjaft në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Pjesa dërmuese e lejeve të ndërtimit është dhënë për ndërtime për banim.

**Grafik 5. Numri i lejeve të ndërtimit sipas tipit të ndërtimit.**



## II.2.2 Tregu i punës

Sipas të dhënave të INSTAT<sup>3</sup>, forca e punës për tremujorin e parë të vitit 2005 është ulur me 1 mijë vetë, në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Ndërkohë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004, forca e punës është rritur me 7 mijë vetë. Kjo rritje është pasqyruar në rritjen e numrit të të punësuarve me 12 mijë vetë dhe në rënien e numrit të personave të papunë me 5 mijë vetë, në terma vjetore.

Nga të punësuarit gjithsej, 19 për qind janë të punësuar në sektorin shtetëror, 58 për qind janë të punësuar në sektorin bujqësor dhe 23 për qind në sektorin privat jobujqësor. Kjo strukturë shpërndarjeje e të punësuarve sipas sektorëve ka mbetur e pandryshuar gjatë vitit të kaluar dhe tremujorit të parë të vitit 2005. Numri i personave të papunë, gjatë tremujorit të parë, ka rënë me 1 mijë vetë. Në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2004, numri i të papunëve është ulur me 5 mijë vetë. Norma e papunësisë në fund të tremujorit të parë vlerësohet 14.3 për qind, duke qenë norma më e ulët e regjistruar gjatë 7 viteve të fundit.

**Tabelë 4. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë)**

	2004				2005
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I
Forcat e punës gjithsej	1080	1081	1080	1088	1087
<b>A. Të punësuar gjithsej</b>	919	921	922	931	931
i) në sektorin shtetëror	179	179	177	176	176
ii) në sektorin privat jo bujqësor	206	208	211	213	213
iii) në sektorin privat bujqësor	534	534	534	542	542
<b>B. Papunësia</b>					
i) të papunë gjithsej	161	160	158	157	156
ii) përfitojnë pagesë papunësie	11.7	12.3	12	11	14.3
<b>C. Shkalla e papunësisë (në %)</b>	14.9	14.8	14.6	14.4	14.3

Burimi: INSTAT, Konjuktura qershor 2005.

Paga mesatare shtetërore është rritur me 3 për qind gjatë tremujorit të parë vitit 2005. Kjo rritje pasqyron rritjen e pagës në disa grupe punonjësish të arsimit. Paga minimale, pagesa e papunësisë për të papunët e regjistruar dhe ndihma ekonomike mesatare për familje kanë mbetur në të njëjtat nivele të fundvitit të kaluar. Në terma vjetore, paga mesatare shtetërore është rritur me 13 për qind, paga minimale e miratuar është rritur me 7 për qind dhe pagesa e papunësisë është rritur me 10 për qind.

## II.2.3 Sektori fiskal

Treguesit fiskalë kanë qenë përgjithësisht nën nivelin e parashikuar gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit qershor, janë mbledhur 98.3 për qind e të ardhurave të planifikuara dhe është realizuar rreth 97.7 për qind e shpenzimeve të programuara. Për pasojë, deficitin buxhetor në fund të muajit qershor ka shënuar rreth 9.4 miliardë, nga 10.2 miliardë lekë të parashikuara. Në krahasim me të njëjtën periudhë të

<sup>3</sup> Vlerësimet e Ministrisë së Punës dhe e Çështjeve Sociale mbi numrin e të punësuarve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005 mungojnë.

vitet të kaluar, të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore janë rritur respektivisht me 8.7 për qind dhe 9 për qind. Deficiti buxhetor për këtë periudhë është financiar kryesisht me burime të brendshme (7.3 miliardë lekë), ndërkohë që financimi i huaj ishte rreth 43 për qind e shumës së parashikuar.

**Tabelë 5. Ritmet e rritjes së treguesve kryesorë fiskalë (në përqindje)**


	6M '99	6M '00	6M '01	6M '02	6M '03	6M '04	6M '05	Mesatare '99-'05
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>17.6</b>	<b>15.6</b>	<b>1.0</b>	<b>21.4</b>	<b>14.3</b>	<b>7.5</b>	<b>8.7</b>	<b>12.3</b>
Të ardhura tatimore	9.8	30.8	-5.8	27.7	48.5	11.1	8.8	18.7
Të ardhura pushteti lokal	4.3	61.0	36.4	32.5	242.3	18.0	5.2	57.1
Të ardh buxh. pavarur	6.2	16.0	-2.5	31.7	14.9	8.5	11.1	12.3
Të ardhura jotatimore	61.6	-25.2	37.9	-7.8	-9.9	-20.7	-0.6	5.1
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>19.6</b>	<b>1.2</b>	<b>3.6</b>	<b>8.7</b>	<b>9.8</b>	<b>6.4</b>	<b>9.0</b>	<b>8.3</b>
Shpenzime korente	12.9	0.0	-4.8	22.5	11.1	7.7	7.3	8.1
Shpenzime kapitale	77.6	3.9	39.8	-31.4	1.1	-3.0	22.5	15.8
<b>DEFICITI</b>	<b>24.5</b>	<b>-31.8</b>	<b>13.9</b>	<b>-34.9</b>	<b>-19.2</b>	<b>-4.2</b>	<b>12.0</b>	<b>-5.7</b>
Financim i brendshëm	26.6	-8.5	-16.7	-14.0	-10.2	14.6	17.7	1.3
Financim i huaj	23.0	-49.3	55.5	-50.0	-30.4	-34.5	-4.0	-12.8

Burimi: Ministria e Financave.

#### TË ARDHURAT BUXHETORE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, të ardhurat buxhetore ishin rreth 8.7 për qind më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2004. Totali i të ardhurave ishte 93.4 miliardë lekë, nga të cilat rreth 61.8 miliardë janë siguruar nga tatimet dhe doganat, 17 miliardë nga buxheti i pavarur dhe pjesa tjetër nga pushteti lokal dhe burime të tjera. Me përjashtim të të ardhurave nga pushteti lokal, të ardhurat e kategorive të tjera kanë qenë nën nivelin e planifikuar duke qenë, megjithatë, pranë këtij niveli. Të ardhurat nga TVSH, nga akcizat dhe nga doganat kanë qenë më të ulëta nga parashikimi, ndërkohë që e kundërta është vërejtur në të ardhurat nga tatimi mbi fitimin dhe në ato nga taksa e qarkullimit të automjeteve.

**Grafik 6. Struktura e të ardhurave buxhetore (në miliardë lekë - të dhëna mujore).**



Burimi: Ministria e Financave.

Të ardhurat nga tatimet vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave buxhetore, duke përbërë rreth 91 për qind të të ardhurave totale. Struktura e të ardhurave nuk ka shënuar ndryshime të ndjeshme në krahasim me atë të vitit të kaluar.

**Tabelë 6. Të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat (në miliardë lekë – të dhëna progresive).**


	Qershor	Plani 6 -muajor	Realizimi (%)	Ndaj planit vjetor (%)
TOTALI	93.4	95.0	98	45
Të ardhura tatimore	84.8	85.2	99	47
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	28.5	29.4	97	45
Tatimi mbi Fitimin	9.1	8.0	113	57
Akcizat	7.9	8.3	95	43
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3.3	3.4	98	43
Taksa Nacionale dhe të tjera	4.9	6.3	78	40
Taksa Doganore	5.9	6.1	96	38
Taksë e qarkullimit të automjeteve	2.1	1.0	206	98

Burimi: Ministria e Financave.

### SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005, shënuan vlerën 102.9 miliardë lekë, duke e realizuar planin e shpenzimeve në masën 97.7 për qind. Shpenzimet korente janë realizuar në masën 102.9 për qind. Shpenzimet korente për periudhën janar – qershor 2005 përbëjnë 87 për qind të shpenzimeve totale. Në ndryshim nga tre vitet e fundit, ecuria e shpenzimeve kapitale ka patur rritje të ndjeshme gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2005, duke qenë 22.5 për qind më të larta se një vit më parë. Megjithatë, këto shpenzime janë realizuar në masën 80.1 për qind të nivelit të planifikuar. Problematike në këtë drejtim paraqiten shpenzimet kapitale të financuara nga burime të huaja, të cilat janë realizuar vetëm në masën 61 për qind të planit, ndërkohë që shpenzimet e financuara nga burime të brendshme janë realizuar në masën 100 për qind. Shpenzimet për interesat dhe ato për sigurimet sociale kanë mbetur nën nivelin e parashikuar, duke u realizuar përkatësisht në masat 92.8 dhe 98.8 për qind.

**Grafik 7. Struktura e shpenzimeve buxhetore (në miliardë lekë-të dhëna mujore).**



Burimi: Ministria e Financave.

**Tabelë 7. Përbërja e shpenzimeve korente (të dhëna progresive - në milionë lekë)**

	Mars	Qershor	Plani 6 – mujor	Realizimi%	Ndaj planit vjetor
Totali i shpenzimeve	46.8	102.9	105.2	97.75	41.37
Shpenzime Korente	42.0	89.7	87.2	102.86	46.52
Personeli	12.0	24.6	24.6	100.11	44.51
Interesat	7.0	13.2	14.2	92.82	44.05
Të Brendshme	6.8	12.3	12.9	94.93	45.01
Të Huaja	0.3	0.9	1.2	70.71	33.81
Shpenzime Operative Mirëmbajtje	4.5	11.0	9.5	115.62	50.25
Subvencionet	0.6	1.7	1.2	143.74	63.23
Shpenzime për Sig.Sociale dhe të tjera	12.7	26.2	26.5	98.76	47.46
Shpenzime për Buxhetin Lokal	3.0	8.0	6.5	124.20	45.57
Shpenzime të tjera	2.2	5.0	4.8	104.82	48.67

Burimi: Ministria e Financave.

## II.2.4 Sektori i jashtëm

Bilanci i pagesave të Shqipërisë është mbyllur me një rezultat pozitiv gjatë tremujorit të parë të vitit, i shprehur me rritjen e rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë. Llogaria korente, gjatë periudhës janar-mars të këtij viti, rezultoi me një deficit prej 56.2 milionë usd, duke shënuar një përkeqësim të lehtë ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë, por një ngushtim të dukshëm të deficitit në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2004. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 26 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Ndërkohë që ritmet e rritjes së importeve dhe të eksporteve të mallrave kanë qenë të përafërta, vëllimi i madh i importeve ka rezultuar në thellim të deficitit korent. Deficiti tregtar prej 363 milionë usd dhe deficiti prej rreth 40 milionë usd i kategorisë së shërbimeve janë mbuluar në pjesën më të madhe nga flukset hyrëse të transfertave korente, kryesisht private. Flukset neto hyrëse të kapitalit, gjatë tremujorit të parë, shënuan 60 milionë usd dhe kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar deficitin korent. Në të njëjtën kohë, në bilancin tonë të pagesave është regjistruar një rritje e rezervave valutore me rreth 13 milionë usd.

### LLOGARIA KORENTE

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti është realizuar një vëllim transaksionesh korente prej rreth 1.7 miliardë usd. Aktiviteti më i madh në kategorinë e transaksioneve korente vazhdon të jetë ai i tregtisë në mallra, i pasuar nga shkëmbimet e shërbimeve. Shpenzimet korente për këtë periudhë vlerësohen në rreth 860 milionë usd, prej të cilave 60 për qind kanë shkuar për financimin e importeve të mallrave dhe 30 për qind për financimin e shërbimeve të blera nga rezidentët jashtë. Eksportet e mallrave për tremujorin e parë të këtij viti ishin tre herë më të pakta nga importet, ndërkohë që eksportet e shërbimeve financuan rreth 90 për qind të shpenzimeve të rezidentëve për shërbime jashtë. Transfertat korente kanë vazhduar të shënojnë flukse neto pozitive, duke shërbyer si balancuese të shpenzimeve të larta për blerje mallrash dhe shërbimesh. Llogaria e transfertave korente, në fund të tremujorit të parë, ishte 297 milionë usd, ose rreth 33 për qind më e lartë sesa ajo e tremujorit të parë të vitit të kaluar.

Shkëmbimet tregtare në mallra vazhdojnë të karakterizohen nga një kërkesë e lartë për importe dhe nga eksporte të kufizuara, të cilat, megjithatë, kanë shënuar rritje të vazhdueshme përgjatë tremujorëve të fundit. Rreth një e treta e mallrave të importit përfaqësohen nga mallra të konsumit, ndërkohë që pjesa dërrmuese e importeve vjen në formën e mallrave të ndërmjetme.

Rritja në importet e mallrave kapitale është një tregues i mirë për ecurinë e investimeve në vend. Eksportet kanë vazhduar të dominohen nga riekportet, të cilat gjatë tremujorit të parë të vitit kanë përfaqësuar rreth 80 për qind të totalit të eksporteve.

Gjatë tremujorit të parë të vitit, rezidentët kanë shpenzuar rreth 300 milionë usd për shërbime të siguruara nga jorezidentët dhe kanë siguruar rreth 260 milionë usd për ofrimin e këtyre shërbimeve ndaj jorezidentëve. Kategoria 'Udhëtime' ose 'Turizëm' vazhdon të jetë zëri që regjistron të hyrat dhe të dalat më të larta midis llojeve të ndryshme të shërbimeve. Gjatë kësaj periudhe, jorezidentët kanë shpenzuar në Shqipëri rreth 200 milionë usd. Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim është rritja e numrit të udhëtarëve jorezidentë me rreth 15 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë vjet. Paralelisht me rritjen e të ardhurave nga turizmi, janë rritur edhe shpenzimet e rezidentëve për turizëm jashtë. Ky fenomen ka çuar në ngushtimin e suficitit të shërbimeve të udhëtimit.

**Tabelë 8. Bilanci i pagesave (në milionë usd)**

	<b>T1-04</b>	<b>T4-04</b>	<b>T1-05</b>
<b>1. Llogaria korente (A+B+C+D)</b>	<b>-45.8</b>	<b>-167.3</b>	<b>-56.2</b>
A. Tregtia në mallra	-317.9	-509.8	-363.0
A.1 Importet në mallra	-454.4	-671.5	-521.5
A.2. Eksportet në mallra	136.5	161.7	158.5
B. Tregtia në shërbime	12.2	-38.1	-37.0
B.1. Importet në shërbime	-208.2	-299.2	-301.7
B.2. Eksportet në shërbime	220.4	261.1	264.7
C. Të ardhurat	37.5	42.4	46.4
C.1. Dalje	-5.3	-8.6	-5.0
C.2. Hyrje	42.8	51	51.4
D. Transferrat korente	222.4	338.2	297.3
D.1. Dalje	-17.3	-30.3	-34.8
D.2. Hyrje	239.7	368.5	332.1
<b>2. Llogaria kapitale dhe financiare (E+F)</b>	<b>65.0</b>	<b>188.8</b>	<b>60.0</b>
E. Llogaria kapitale	34	37	46.6
F. Llogaria financiare	31	151.8	13.4
<b>3. Gabime dhe harresa neto</b>	<b>-10.2</b>	<b>39.1</b>	<b>2.8</b>
<b>4. Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>14.9</b>	<b>60.6</b>	<b>12.7</b>
<b>5. Rritja e rezervave</b>	<b>-14.9</b>	<b>-60.6</b>	<b>-12.7</b>

#### **LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE**

Si llogaria kapitale, ashtu edhe ajo financiare e kanë mbyllur tremujorin e parë me flukse neto pozitive. Bilanci i përbashkët shënoi 66 milionë usd nga të cilat 47 milionë usd kanë ardhur në formë fluksesh kapitale dhe 19 milionë usd në formë fluksesh financiare. Këto të fundit kanë qenë rezultat i rritjes së detyrimeve financiarë të vendit ndaj botës me 64 milionë usd dhe i rritjes së mjeteve të rezidentëve jashtë me 44 milionë usd. Rritja e detyrimeve të rezidentëve është përfaqësuar kryesisht nga hyrja e investimeve të huaja direkte në vend. Këto të fundit, gjatë këtij tremujori, kanë qenë rreth 54 milionë usd, duke qenë më të larta se investimet e të njëjtit tremujor gjatë vitit të kaluar. Shqipëria gjatë kësaj periudhe ka rritur stokun e borxhit të saj të jashtëm me rreth 22 milionë usd, ndërkohë që ulja e detyrimeve të borxhit si pasojë e shlyerjes së principalit dhe të interesave ka qenë 10 milionë usd. Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, investimet e portofolit të rezidentëve jashtë janë rritur me 56 milionë usd, duke arritur nivelin prej 200 milionë usd. Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u pasqyruan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 13 milionë usd. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliard e 350 milionë usd, i mjaftueshëm për të përballuar 4.9 muaj importe mallrash dhe shërbimesh nga 4.6 në tremujorin e parë të vitit 2004.



## II.3 ECURIA E INFLACIONIT GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË.

Gjashtëmuji i parë i vitit 2005 është karakterizuar nga norma të ulëta inflacioni. Inflacioni vjetor ka rënë gradualisht gjatë pjesës së parë të vitit, duke arritur vlerën 1.3 për qind në muajin prill, ndërkohë që muajt maj dhe qershor shënuan një rritje të lehtë të inflacionit deri në nivelin 2.9 për qind. Ndërsa norma vjetore ka shënuar luhatje, norma mesatare vjetore për secilin nga muajt e kësaj periudhe ka qenë brenda intervalit 2 - 4 për qind. Inflacioni mesatar ka ndjekur një trajektore rënëse gjatë katër muajve të parë të vitit, duke qëndruar i fiksuar në vlerën 2.25 për qind, gjatë dy muajve pasues.

**Tabelë 9. Norma vjetore e inflacionit (në përqind).**

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
<b>Mesatar</b>	<b>3.1</b>	<b>5.2</b>	<b>2.2</b>	<b>3.0</b>	<b>2.3</b>


Burimi: INSTAT.

Harmonizimi i mirë i politikave fiskale dhe monetare si dhe zhvillimet pozitive në grupe të ndryshme mallrash të konsumit, brenda një mjedisi makroekonomik të përshtatshëm, kanë mundësuar kontrollimin e normës së inflacionit.

Bashkëveprimi i faktorëve të kërkesës dhe të ofertës nuk ka rezultuar në presione inflacioniste gjatë kësaj periudhe. Rritja modeste e pagave, rritja e çmimeve të naftës dhe rritja e çmimeve të administruara në fillim të vitit kanë ushtruar presione për rritjen e çmimeve të konsumit. Veprimi i këtyre faktorëve është balancuar nga niveli i qëndrueshëm i kërkesës së brendshme<sup>4</sup>, ecuria e qëndrueshme e kursit të këmbimit të lekut dhe prodhimi bujqësor në vend.

<sup>4</sup> E vlerësuar nga ecuria e indeksit të shitjeve dhe të tregtisë me pakicë, publikuar nga INSTAT.


**Grafik 8. Inflacioni vjetor (në përqind).**



**II.3.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse.**

Zhvillimet në normën vjetore të inflacionit, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005, mund të ndahen në dy periudha. Gjatë periudhës shkurt - prill, indeksi i çmimeve të konsumit manifestoi një tendencë rënëse, duke zbritur nën nivelin 2 për qind. Pas muajit prill, inflacioni vjetor shënoi rritje duke arritur vlerën 2.9 për qind në fund të gjashtëmuajorit.

**Grafik 9. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).**



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Rënia e çmimeve të produkteve ushqimore dhe në veçanti e artikujve bujqësorë, ashtu si edhe vitin e kaluar, ka vazhduar të ushtrojë presion për rënie të çmimeve të konsumit gjatë pesë muajve të parë të vitit 2005. Grupi 'Ushqime dhe pije joalkoolike' ka shënuar norma vjetore negative të inflacionit, me përjashtim të muajit qershor. Gjatë pesë muajve të parë të vitit, kontributi i këtij grupi në normën vjetore të inflacionit ishte mesatarisht - 0.6 pikë përqindjeje, duke qenë mjaft më i ulët se kontributi 0.6 pikë përqindjeje për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në ndryshim nga viti i kaluar, inflacioni i këtij grupi shënoi një kthesë në muajin qershor duke regjistruar një normë pozitive inflacioni prej 1.6 për qind dhe duke kontribuar me 0.7 për qind në normën totale të inflacionit. Ky zhvillim reflektoi një tkurrje të përkohshme oferte, si pasojë e zëvendësimit të produkteve të serrave me produkte të fushës. Prodhimi bujqësor i serrave, i cili është i pranishëm në treg gjatë gjithë vitit, rënia e çmimeve ushqimore në tregjet e partnerëve tregtarë si Italia dhe Greqia, si dhe mbiçmimi i lekut ndaj euros kanë ulur presionet inflacioniste të mallrave të këtij grupi.

**Tabelë 10. Norma vjetore e inflacionit të grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” (në vend dhe jashtë) si dhe kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total.**

	Inflacioni vjetor '04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor '05	Kontributi (pp)	Itali <sup>5</sup> Inflacioni vjetor '05	Greqi <sup>6</sup> Inflacioni vjetor '05
Janar	3.2	1.4	-0.7	-0.3	-0.5	0.6
Shkurt	2.7	1.2	-1.2	-0.5	-0.2	-0.9
Mars	2.3	1.0	-1.7	-0.7	-0.2	-1.4
Prill	0.1	0.1	-2.3	-1.0	-0.1	-0.1
Maj	-1.1	-0.5	-0.7	-0.3	-0.2	-0.4
Qershor	-0.7	-0.3	1.6	0.7	-0.5	-0.5

Një faktor tjetër mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e profilit të normës vjetore të inflacionit gjatë dy viteve të fundit, ka qenë ecuria e çmimeve të administruara. Ky faktor ka qenë i pranishëm edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005. Rritja e çmimit të energjisë me 25.7 për qind në muajin janar u përkthye në rritje të inflacionit vjetor të grupit ‘Qira, ujë, lëndë djegëse, energji’ në 15.2 për qind në këtë muaj. Pas shuarjes në muajin shkurt të efektit të rritjes së vjetshme të çmimit të energjisë, kontributi mesatar (2.3 pikë përqindjeje) i këtij grupi në shifrën totale të inflacionit gjatë këtij gjashtëmuajori, ishte pothuajse i njëjtë me atë të gjashtëmuajorit të parë të vitit të kaluar (2.0 pikë përqindjeje).

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005, inflacioni vjetor i grupit ‘Qira, ujë, lëndë djegëse, energji’ ka ardhur në rënie duke reflektuar uljen e çmimeve të qirasë dhe të rentës së imputuar. Nëngrupet ‘Qira’ dhe ‘Renta e imputuar’, kanë ruajtur të pandryshuar normën e tyre vjetore të inflacionit 2.3 për qind, për periudhën prill '05 – qershor '05.

**Tabelë 11. Norma vjetore e inflacionit dhe kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” në inflacionin total.**

	Inflacioni vjetor '04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor '05	Kontributi (pp)
Janar	3.7	0.9	15.2	3.6
Shkurt	8.5	2.0	9.8	2.4
Mars	8.3	1.9	9.9	2.4
Prill	11.0	2.5	7.2	1.8
Maj	10.0	2.3	7.2	1.8
Qershor	9.7	2.3	7.1	1.8

Një grup tjetër, zhvillimet e të cilit kushtëzohen nga lëvizjet në çmimet e administruara, është grupi ‘Komunikimi’. Ndryshimet e bëra në vitin e kaluar në tarifën e telefonisë fikse, janë pasqyruar në inflacionin vjetor të gjashtë muajve të parë të këtij viti. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, grupi ‘Komunikimi’ ka ulur normën vjetore të inflacionit me rreth 0.5 pikë përqindje, ndërsa gjatë tremujorit të dytë, kontributi i këtij grupi është shuar. Muaji prill '05 shënoi shuarjen e efektit të uljes së tarifave një vit më parë<sup>7</sup>, duke bërë që kontributi i mëtejshëm i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total të bëhet i pandjeshëm.

Rritja e çmimit të naftës, megjithëse përbën një kosto potenciale në tregun shqiptar, ka transmetuar presione të dobëta inflacioniste në indeksin e çmimeve të konsumit. Inflacioni i grupit ‘Transport’, gjatë kësaj periudhe ka qenë, më i ulët sesa vlerat e arritura gjatë pjesës më të


<sup>5</sup> Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>.

<sup>6</sup> Burimi: General Secretariat of National Statistical Service of Greece, <http://www.statistics.gr>.

<sup>7</sup> Vendimi i marrë në muajin prill '04 për të ulur tarifën me 28.5 për qind pas rritjes së saj në muajin dhjetor '03.


madhe të vitit të kaluar. Inflacioni vjetor i këtij grupi, gjatë gjashtëmujorit të parë, ka shënuar normën më të lartë në muajin prill (3.3 për qind). Gjatë periudhës janar - qershor, ky grup ka dhënë një kontribut mesatar në vlerën totale të inflacionit prej 0.13 pikësh përqindjeje.

**Grafik 10. Kontributi i grupeve të tjera në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).**



Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005, grupet e tjera të shportës nuk kanë ecur në të njëjtin drejtim përsa i përket ecurisë së çmimeve. Ndikimi i tyre rezultat në normën e inflacionit është i vogël. Inflacion më të lartë kanë shënuar grupet e përbërë kryesisht nga mallra dhe shërbime me çmime të administruara, si 'Shëndeti' dhe 'Shërbimi arsimor', por dhe grupet 'Pije alkoolike dhe duhan', 'Mallra dhe Shërbime të ndryshme'. Grupet si 'Veshje dhe këpucë', 'Mobilim, pajisje dhe mirëmbajtje shtëpie' dhe 'Argëtim e kulturë' kanë vazhduar të regjistrojnë norma negative të inflacionit, ndërsa grupi 'Hotele, kafene, restorante' ka regjistruar ritme më të ulëta rritjeje. Këto grupe kanë kontribuar mesatarisht në inflacionin vjetor me 0.05 pikë përqindjeje.

**Grafik 11. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).**



### II.3.2 Ambianti makroekonomik dhe çmimet e konsumit


Ambianti makroekonomik ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005. Politika monetare e kujdesshme dhe mungesa e presioneve inflacioniste nga ana e faktorëve të ofertës apo të kërkesës, kanë bërë të mundur kontrollin e normës së inflacionit. Impulset inflacioniste të dhëna nga rritja e pagave, nga rritja e çmimit të naftës dhe nga rritja e çmimeve të administruara, janë ekuilibruar nga zhvillimet në kursin e këmbimit dhe nga ecuria e mirë e prodhimit të brendshëm.

#### FAKTORËT E KËRKESËS.

##### POLITIKA FISKALE DHE TREGUESIT FISKALË.

Politika fiskale dhe treguesit fiskalë nuk kanë patur shmangie të ndjeshme nga buxheti i miratuar. Gjatë pesë muajve të parë të këtij viti është vënë re një tendencë rritjeje vjetore e shpenzimeve buxhetore. Megjithatë, rritja e shpenzimeve korente dhe kapitale ka qenë brenda parashikimit dhe në përputhje me objektivat e tjerë makroekonomikë. Rritja e shpenzimeve korente është ndikuar edhe nga rritja e rrogave në sektorin publik, rritje kjo e cila nuk ka shkaktuar presione inflacioniste gjatë gjysmës së parë të vitit 2005.

**Grafik 12. Rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore (boshti majtas) dhe norma vjetore e inflacionit (boshti djathtas)**




##### POLITIKA MONETARE DHE TREGUESIT MONETARË.

Politika monetare ushtron një ndikim afatgjatë në inflacion, nëpërmjet kontrollit të agregatëve monetarë, dhe një ndikim afatmesëm në aktivitetin ekonomik dhe në inflacion, nëpërmjet rregullimit të normës së interesit. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti, Banka e Shqipërisë ka ulur normën e interesit me 0.25 pikë përqindjeje, duke e çuar atë në nivelin 5.0 për qind. Lehtësimi i politikës monetare ka ndikuar në nxitjen e mëtejshme të kreditimit të ekonomisë. Megjithatë, inflacioni i ulët ka bërë të mundur ruajtjen e normës reale të interesit në terma pozitive. Ajo ka mundësuar arritjen e një ekuilibri të përshtatshëm midis rritjes së agregatëve monetarë (si pasojë e rritjes së kredisë) dhe rritjes së përmbajtjes së likuiditetit në ekonomi, duke mos injektuar impulse të pakontrolluara të inflacionit. Gjithashtu, tendenca rënëse e raportit të

parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare është ruajtur gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti. Në muajin maj, ky raport rezultoi 24.5 për qind.

**Grafik 13. Treguesit kryesorë monetarë.**



**TREGUES TË TJERË.**

**Indeksi i tregtisë me pakicë<sup>8</sup>.** Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, ky tregues nuk ndryshoi ndjeshëm, duke ndjekur modelin sezonal të ekonomisë, i cili shfaq një ngadalësim gjatë kësaj periudhe të vitit. Indeksi i tregtisë me pakicë u ul me 2.5 për qind ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Sjellja e këtij treguesi mund të interpretohet si një qëndrueshmëri e kërkesës së brendshme, duke ndikuar kështu në mbajtjen nën kontroll të presioneve inflacioniste nga ana e kërkesës.

**FAKTORËT E OFERTËS.**

**ECURIA E PRODHIMIT TË BRENDSHËM BUJQËSOR.**

Gjatë vitit të kaluar prodhimi i brendshëm bujqësor shënoi një rritje të vullshme. Rritja e prodhimit erdhi si pasojë jo vetëm e një viti të mbarë bujqësor, por dhe e rritjes së investimeve në ndërtimin e serrave, prodhimi i të cilave, ishte i pranishëm në treg edhe gjatë këtij gjashtëmuajori.

**ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT DHE INFLACIONI I IMPORTUAR.**

Një nga faktorët përcaktues të zhvillimeve në inflacionin e vendit është kursi i këmbimit. Prej një periudhe të gjatë kohe leku ka shfaqur një tendencë mbiçmuese ndaj dy monedhave kryesore - euros dhe dollarit amerikan. Gjatë këtij gjashtëmuajori është ruajtur e njëjta dinamikë, por me ritme më të zbutura të mbiçmimit vjetor të lekut. Afrimi i sezonit turistik dhe i stinës së verës shoqërohen me flukse të mëdha të valutës (kryesisht euro) dhe me rritje të kërkesës për lekun,

<sup>8</sup> Burimi INSTAT.

domethënë mbiçmimin e tij. Ecuria e favorshme e kursit të këmbimit ka arritur të amortizojë presionet inflacionit që përcillen në vend nga inflacioni i importuar.

**Tabelë 12. Ndryshimet vjetore në inflacionin e vendeve partnere dhe në kursin e këmbimit (në përqindje).**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Greqi <sup>9</sup>	4.0	3.1	2.9	3.4	3.2	3.3
Itali <sup>10</sup>	1.8	1.8	1.7	1.9	1.7	
Lek/Euro	-5.3	-4.8	-3.1	-1.6	-2.3	-1.0
Lek/Usd	-8.8	-7.4	-9.8	-8.9	-7.4	-1.2

Një ekonomi e vogël dhe e hapur ndaj tregut të jashtëm si Shqipëria, ndikohet në mënyrë të pashmangshme nga inflacioni i importuar. Inflacioni i importuar është një kombinim i zhvillimeve në çmimet e konsumit të vendeve partnere me ecurinë e kursit të këmbimit. Partnerët kryesorë tregtarë të vendit tonë, Italia dhe Greqia, kanë shënuar norma të ulëta të inflacionit. Normat e ulëta dhe të qëndrueshme të ndryshimeve vjetore të çmimeve të konsumit në këto vende, shoqëruar nga mbiçmimi vjetor i lekut ndaj euros kanë rezultuar në ulje të çmimeve të importuara të shprehura në lekë.

Inflacioni i importuar nuk ka ushtruar presione të forta inflacioniste. Për më tepër, çmimet më të lira të mallrave të importit kanë ushtruar një presion konkurrencial rënës edhe në çmimet e mallrave të vendit.

**Box. INFLACIONI I IMPORTUAR.**

Në mungesë të të dhënave të çmimeve të importit, u krye një llogaritje e thjeshtë për të vlerësuar ecurinë e inflacionit të importuar gjatë periudhës janar '02 – maj '05.

Peshën më të madhe në importet shqiptare e zënë importet nga Italia dhe Greqia, përkatësisht me 31.6 dhe 15.7 për qind të importeve totale. Për të vlerësuar ecurinë dhe ndikimin e çmimeve të importuara (në terma të monedhës vendase) në inflacionin në vend, u ndërtua indeksi i çmimeve të importit, duke marrë parasysh importet e Italisë dhe të Greqisë. Peshat që zënë importet e këtyre vendeve ndaj importeve totale për tremujorin e parë të vitit 2005 u mbajtën konstante. Indeksi i çmimeve të importit u ndërtua në dy hapa:


- u llogarit një indeks çmimesh të huaja si mesatare e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të Italisë dhe të Greqisë me peshat përkatëse dhe,
- ky indeks u përkthye në terma leku, duke u shumëzuar me kursin e këmbimit lek/euro për periudhën janar'02 - maj'05.

Në grafikun e mëposhtëm jepen ndryshimet vjetore të inflacionit të importuar, të inflacionit në vend dhe të kursit të këmbimit të lekut ndaj euros.

**Ecuria e inflacionit të importuar dhe në vend dhe e kursit nominal të këmbimit (boshti djathtas).**

<sup>9</sup> Burimi: Faqja e internetit e General Secretariat of National Statistical Service of Greece <http://www.statistics.gr>.

<sup>10</sup> Burimi: Faqja e internetit e ISTAT, <http://www.istat.it>.




Inflacioni i importuar nuk ka ushtruar presione inflacioniste në vend. Natyrshist që një konkluzion i fillë duhet të korrektohet edhe me veçoritë e tregut të brendshëm, veçanërisht me shkallën e konkurrencës në të, por gjithsesi, ajo ilustron faktin se kombinimi i inflacionit në vendet partnere dhe i ecurisë së kursit të këmbimit nuk ka nxitur presionet inflacioniste në vend. Ashtu siç është theksuar dhe në raportet periodike të Bankës së Shqipërisë, mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut ndaj euros si dhe dollarit ka frenuar presionet inflacioniste të jashtme.

#### INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMIT<sup>11</sup>.

Nga analiza e indeksit të çmimeve të prodhimit, rezulton se çmimet e prodhimit kanë shënuar rritje prej mëse një viti. Megjithatë, tendenca rritëse në hallkën e parë të zinxhirit të tregtimit të mallrave nuk është reflektuar në çmimin përfundimtar, paguar nga konsumatori. Mungesa e transmetimit të kostove mund të shpjegohet nga rritja e konkurrencës në segmentin e tregtisë me pakicë.

**Grafik 14. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të konsumit (në përqindje).**



#### TREGUES TË TJERË.

**Papunësi - paga.** Sipas të dhënave të INSTAT, tremujori i parë i këtij viti nuk solli ndryshime domethënëse në normën e papunësisë dhe në nivelin e përgjithshëm të pagave. Norma e papunësisë u ul lehtësisht në 14.3 për qind, kurse pagat mesatare në sektorin publik u rritën me 3 për qind ndaj tremujorit paraardhës. Rritja e pagave në sektorin publik vjen kryesisht nga rritja e pagave për disa grupe punonjësish në sistemin shëndetësor dhe arsimor. Nga ana tjetër, paga

<sup>11</sup> Burimi INSTAT, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit.



minimale, pagesa e papunësisë për të papunët, si dhe ndihma ekonomike mesatare për familje mbetën të pandryshuar. Inflacioni i ulët gjatë këtij gjashtëmujori tregon për mospërçimin, të paktën në mënyrë direkte, të presioneve inflacioniste nëpërmjet spirales pagë – inflacion.

**Çmimet e naftës.** Ashtu si dhe gjatë vitit të kaluar, ky faktor nuk ka ndikuar në inflacionin në vend. Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar nuk është përcjellë e plotë në tregun e brendshëm, prej kombinimit të një sërë faktorëve si: mbiçmimi i monedhës sonë ndaj dollarit, ulja e kërkesës në vend (prej 23.5 për qind<sup>12</sup> ndaj tremujorit të fundit të vitit 2004) dhe pesha e vogël<sup>13</sup> që zë grupi 'Transport' në shportën e mallrave të konsumit. Nga ana tjetër, çmimi i prodhimit të naftës gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, është rritur ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar me mesatarisht 2.6 për qind.

---

<sup>12</sup> Burimi INSTAT, Konjuktura janar – mars 2005.


<sup>13</sup> Pesha e këtij grupi në shportën e mallrave të konsumit është 4.8 për qind.

### III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

#### III.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur përgjithësisht një kah zbutës gjatë gjashtëmujorit të parë. Kjo tendencë ka qenë më e theksuar në tremujorin e parë, duke u finalizuar me uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit në datën 30 mars, ndërkohë që gjatë tremujorit të dytë, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare më neutrale. Kjo politikë ka qenë në përputhje me dinamikën e presioneve inflacioniste në ekonomi. Vlerat faktike të inflacionit kanë qenë në nivele relativisht të ulëta, ndërsa treguesit monetarë kanë shfaqur stabilitet, duke ndikuar në një tablo optimiste të parashikimit të inflacionit.

**Grafik 15. Norma bazë e interesit.**



Efekti i uljes së normës bazë të interesit është pasqyruar dukshëm në normat e interesit të depozitave, ndërkohë që masa e reagimit të normave të bonove të thesarit ka rezultuar e afërt me uljen e sinjalizuar. Ulja e normave të interesit të depozitave nga bankat e nivelit të dytë ka qenë më e theksuar për maturitetet afatmesme duke ndikuar në sheshimin e kurbës së normave të interesave.

**Tabelë 13. Reagimi i normave të interesit në tregun bankar (në pikë përqindjeje).**

Afati i maturimit	Depozita me afat	Yield-i letrave me vlerë të qeverisë
3-mujor	(1.14)	(0.20)
6-mujor	(1.32)	(0.09)
12-mujor	(1.71)	(0.32)
24-mujor	(2.28) *	(0.30)

Të dhëna operative për periudhën 30 mars – 8 korrik.

\*Ndryshimi për periudhën 30 mars – 1 korrik.

Politika monetare zbutëse e Bankës së Shqipërisë është pasuar nga rritja e kërkesës për mjete monetare. Burimi kryesor i zgjerimit monetar gjatë kësaj periudhe ka qenë kreditimi i ekonomisë, në ndryshim nga vitet e kaluara, kur këtë funksion e ka realizuar huamarrja e qeverisë apo flukset hyrëse valutore. Normat e ulëta të inflacionit gjatë kësaj periudhe kanë mundur ritme të larta rritjeje të agregatëve monetarë në terma realë. Rritja vjetore e treguesit M3 real ka ruajtur të njëjtën tendencë të dy viteve të fundit.

Në tregjet e parasë, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë janë kufizuar në tërheqjen e likuiditetit nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me çmim fiks dhe shumë të pakufizuar. Banka e Shqipërisë ka lehtësuar funksionimin e tregjeve monetare me anë të instrumenteve mbështetëse, kryesisht

përdorimit të depozitës njëditore. Zhvillimi i operacioneve monetare ka krijuar kushtet për transmetim të sinjalit të politikës monetare dhe është shoqëruar me ulje të normave të interesit në tregjet monetare. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka mundur gjithashtu respektimin e objektivave sasiorë të saj.

**Tabelë 14. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.**


	Dhjetor '04	Janar '05	Shkurt '05	Mars '05	Prill '05	Maj '05
<b>Rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë (në milionë dollarë)</b>						
Objektivi	941.7	985.3	1,029.0	1,072.7	1,077.3	1,082.0
Aktuale	1,105.2	1,108.8	1,108.7	1,107.4	1,109.0	1,104.6
Diferenca	163.5	123.5	79.7	34.8	31.7	22.6
<b>Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë (në miliardë lekë)</b>						
Objektivi	79.0	73.1	67.2	61.3	61.6	61.9
Aktuale	61.0	56.3	56.5	53.3	56.1	57.0
Diferenca	-18.0	-16.7	-10.7	-7.9	-5.5	-4.9
<b>Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)</b>						
Objektivi	286.4	288.2	289.9	291.7	293.7	295.7
Aktuale	285.7	286.9	288.9	287.8	290.4	291.3
Diferenca	-0.7	-1.3	-1.0	-3.9	-3.3	-4.3

## III.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Zhvillimet monetare, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2005, kanë ndjekur në vija të përgjithshme tendencat e parashikuara në programin monetar. Ashtu siç pritej, ritmi i rritjes së ofertës monetare ka shënuar rritje, duke qenë konsistent me ecurinë pozitive të aktivitetit ekonomik në periudhën aktuale dhe me rritjen e volumit të parasë së mbajtur nga agjentët ekonomikë për financimin e transaksioneve të tyre. Gjithashtu, rritja e ofertës monetare gjatë kësaj periudhe, ka reflektuar edhe zhvillimet pozitive në drejtim të thellimit të ndërmjetësimit financiar në vend dhe konsolidimit të besimit në sistemin bankar. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, evidentohet një rritje më e madhe e mjeteve monetare më pak likuide dhe, në veçanti, e depozitave me afat në valutë.


Norma e rritjes vjetore të ofertës monetare në muajin maj arriti në 15.8 për qind, nga 13.1 për qind që ishte në muajin dhjetor. Rritja e ofertës monetare gjatë kësaj periudhe është mbështetur në rritjen më të shpejtë të depozitave në valutë dhe në ruajtjen e një kahu të moderuar rritës të agregatit M2. Kontributi i kredisë për ekonominë në gjenerimin e mjeteve monetare në lekë ka ardhur në rritje, ndërkohë që kërkesa për para e qeverisë ka qenë pothuajse në të njëjtat nivele të një viti më parë. Zhvillimet në strukturën kohore dhe valutore të ofertës monetare tregojnë për ruajtjen dhe përforcimin e tendencave të tyre të mëparshme. Gjatë pesë muajve të parë të vitit 2005, raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 ka shënuar rënie të ndjeshme, duke zbritur në nivelin e tij minimal historik, ndërsa raporti i depozitave në valutë ndaj ofertës monetare ka qenë vazhdimisht në rritje.

**Grafik 16. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.**



Treguesi i parasë jashtë bankave ka qenë përbërësi me rritjen më të ngadaltë në ofertën monetare. Norma e rritjes vjetore të saj, gjatë periudhës janar– maj, është rritur lehtësisht nga 10.3 për qind në 11.6 për qind, duke ndjekur të njëjtin kah rritës të agregatëve M2 dhe M3. Tendencë më e ngadaltë rritëse e parasë jashtë bankave në krahasim me përbërësit e tjerë të ofertës monetare është shoqëruar me rënien e ndjeshme të raportit PjB / M3. Në fund të muajit maj, ky raport zbriti në nivelin 24.7 për qind, duke shënuar një rënie prej 2.7 pikësh përqindjeje kundrejt muajit dhjetor dhe prej 0.9 pikësh përqindjeje kundrejt muajit maj të vitit të kaluar.

**Grafik 17. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real.**



Vazhdimi i tendencës rënëse të këtij treguesi i kushtohet kryesisht zhvillimeve pozitive në infrastrukturën e pagesave, të cilat janë shoqëruar me rritjen e përdorimit të shërbimeve bankare nga ana e publikut. Në të njëjtën kohë, ruajtja e normave reale të interesit në nivele të qëndrueshme pozitive ka mbështetur investimet në instrumentet financiare në lekë, duke shërbyer si premisë për mbajtjen në ekuilibër të strukturës së likuiditetit të ofertës monetare.

Tendencë në rritje e agregatit M2 dhe vazhdimi i kthimit të parasë jashtë bankave në sistem, janë reflektuar në përsheptimin e ritmeve të rritjes së depozitave në lekë. Norma e rritjes vjetore të tyre në muajin maj arriti në 14.6 për qind, nga 12.9 që ishte në muajin dhjetor. Ecuria në rritje e depozitave në lekë ka pasqyruar kryesisht kontributin më të lartë të depozitave me afat të individëve, rritja e të cilave ka përbërë rreth 67 për qind të rritjes totale të depozitave në periudhën janar – maj. Gjithashtu, depozitat në lekë të sektorit privat dhe depozitat pa afat në

lekë të individëve kanë manifestuar ritme të larta rritjeje, duke ndikuar pozitivisht në ecurinë e depozitave në lekë.

Struktura kohore e depozitave në lekë ka njohur një rritje të peshës së depozitave pa afat, e ndikuar nga zhvendosja e depozitave të sektorit shtetëror nga depozita me afat në depozita pa afat<sup>14</sup>. Ky zhvillim ka përcaktuar edhe ecurinë e agregatit M1, norma e rritjes vjetore të të cilit është rritur nga 19.4 për qind në muajin dhjetor në 24 për qind në muajin maj. Në mungesë të kësaj zhvendosjeje, rritja vjetore e agregatit M1 në muajin maj do të rezultonte 20.1 për qind, duke paraqitur një tendencë rritëse më të moderuar sesa ajo e treguesve më të gjerë të parasë.

**Tabelë 15. Ecuria e treguesve monetarë në muajin maj (në miliardë lekë).**

	Maj	Ndryshimi 5-mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Para jashtë bankave	130.7	-7.4	-5.4	13.6	11.6
Depozita totale	402.5	33.4	9.0	59.4	17.3
- në lekë	270.5	17.2	6.8	34.5	14.6
- në valutë	132.0	16.2	14.0	24.9	23.2
Depozita pa afat	89.2	11.6	15.0	22.5	33.7
- në lekë	42.5	7.8	22.3	20.0	88.6
- në valutë	46.7	3.9	9.0	2.6	5.8
Depozita me afat	313.3	21.8	7.5	36.9	13.3
- në lekë	228.0	9.4	4.3	14.5	6.8
- në valutë	85.3	12.3	16.9	22.3	35.5
M1	173.2	0.4	0.2	33.5	24.0
M2	401.2	9.8	2.5	48.1	13.6
M3	533.2	26.0	5.1	72.9	15.8
Baza monetare	174.5	-4.1	-2.3	20.9	13.6

Gjashtëmujori i parë i vitit ka shfaqur një rritje të ndjeshme të kontributit të depozitave në valutë në rritjen e ofertës monetare. Norma e rritjes vjetore të tyre në fund të muajit maj u rrit në 23.2 për qind, nga 17.1 për qind që ishte në fund të muajit dhjetor. Kjo ecuri e depozitave në valutë ka pasqyruar kryesisht nënçmimin e kursit të këmbimit të lekut gjatë periudhës janar – maj<sup>15</sup>, si rezultat i të cilit është ulur ndjeshëm efekti negativ i mbiçmimit vjetor të lekut, nga -9.2 për qind në muajin dhjetor, në -3.5 për qind në muajin maj. Në terma realë, norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë ka patur një ecuri të qëndrueshme, duke shënuar një nivel të lartë prej 27.6 për qind në muajin maj.


Kontributin kryesor në rritjen e depozitave në valutë e kanë dhënë depozitat me afat dhe ato të individëve, të cilat kanë përbërë përkatësisht rreth 76 për qind dhe 73 për qind të rritjes së depozitave totale në valutë për periudhën janar - maj. Rritja më e madhe e depozitave me afat në valutë të individëve vlerësohet të jetë ndikuar nga vazhdimi i flukseve të larta valutore nga remitancat, rritja e besimit në sistemin bankar dhe normat më të favorshme të interesit në dollarë.

<sup>14</sup> Efekti i kësaj zhvendosjeje është rreth 4 miliardë lekë. Ai lidhet me transferimin e fondeve të skemave piramidale nga depozita me afat në lekë në llogari rrjedhëse, me qëllim shpërndarjen e mëtejshme të tyre tek kreditorët.

<sup>15</sup> Kursi i këmbimit të lekut ndaj euros dhe dollarit, i kombinuar sipas peshave të këtyre monedhave në depozitat në valutë, është nënmuar me rreth 2.6 për qind në periudhën dhjetor- maj.

Rritja më e shpejtë e depozitave në valutë në krahasim me përbërësin në lekë të ofertës monetare, është shoqëruar me rritjen e peshës së tyre në agregatin M3. Në fund të muajit maj raporti i depozitave në valutë ndaj ofertës monetare arriti në 24.8 për qind, duke shënuar një rritje prej 1.5 pikësh përqindjeje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

**Grafik 18. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.**




### III.3 KËRKESA E BRENDSHME

#### III.3.1 Mjetet valutore neto

Sistemi bankar ka ruajtur një pozicion të qëndrueshëm valutor gjatë pjesës së parë të vitit 2005. Nën ndikimin e nënçmimit të euros ndaj dollarit amerikan, niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar ka shënuar një rënie prej 76.5 milionë usd, ndërkohë që të matura me kurse fikse, ato rezultojnë të jenë rritur me 12.8 milionë usd gjatë periudhës janar - maj. Me zbehjen e efektit të hyrjes së të ardhurave të privatizimit të ish-Bankës së Kursimeve në fillim të vitit të kaluar, kontributi i mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të ofertës monetare ka shënuar rënie, duke tentuar drejt vlerave të tij historike.


**Grafik 19. Kontributi vjetor i rritjes së MVN në rritjen e M3.**



Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë, gjatë pesë muajve të parë të vitit, kanë shënuar një rënie me 46.5 milionë usd. Në mungesë të ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor dhe në prani të flukseve të ulëta hyrëse dhe dalëse të valutës nga burime të tjera, rënia e mjeteve valutore neto gjatë kësaj periudhe është ndikuar tërësisht nga nënçmimi i euros ndaj dollarit. Ky nënçmim, ka ulur vlerën e portofolit në euro të rezervës valutore të shprehur në

dollarë, duke ndikuar negativisht mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë në masën 60.5 milionë usd.

**Grafik 20. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar (në milionë dollarë).**



Mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë kanë pësuar gjithashtu rënie në masën 30 milionë usd. Përshpejtimi i ndjeshëm i kreditimit në valutë gjatë pjesës së parë të vitit, nuk ka mundur të financohet tërësisht nga rritja e depozitave në valutë në bankat tregtare, duke bërë të nevojshëm përdorimin e një pjese të mjeteve valutore të tyre.


### III.3.2 Kërkesa e qeverisë për mjete monetare

Kërkesa e qeverisë për para, gjatë pesë muajve të parë të vitit 2005 ka patur një ecuri të ngjashme me atë të vitit të kaluar. Kontributi relativ i saj në rritjen e ofertës monetare ka vazhduar të jetë i ulët dhe nën nivelin e parashikuar. Llogaritë fiskale të qeverisë tregojnë një rritje progresive të deficitit buxhetor gjatë kësaj periudhe, duke shënuar një nivel kumulativ prej 4.7 miliardë lekësh në fund të muajit maj. Kjo ecuri ka reflektuar financimin me 7.7 miliardë lekë të deficitit në nivel bruto, nga njëra anë, dhe rritjen me 3 miliardë lekë të depozitave të qeverisë në Bankën e Shqipërisë, nga ana tjetër.

Sistemi bankar ka përballuar rreth 56 për qind të nevojave për financim të qeverisë deri në muajin maj, duke rritur me 3.3 miliardë lekë portofolin e letrave me vlerë në zotërim të tij. Kjo rritje është pasqyruar plotësisht në rritjen e portofolit të bankave tregtare, ndërkohë që portofoli i Bankës së Shqipërisë ka mbetur i pandryshuar nga niveli i fundit të vitit 2004. Struktura e portofolit të bankave të nivelit të dytë është orientuar drejt emetimeve afatgjata të qeverisë, me rënien e portofolit të bonove të thesarit me 6 miliardë lekë dhe me rritjen e portofolit të obligacioneve qeveritare me 9.3 miliardë lekë<sup>16</sup>. Pjesa tjetër e huamarrjes prej 2.5 miliardë lekësh është financuar nga individët dhe institucionet, me përkatësisht 1.8 dhe 0.7 miliardë lekë.

<sup>16</sup> Rritja në portofolin e obligacioneve qeveritare përbëhet nga rritja me 7.3 miliardë lekë e obligacioneve dyvjeçare dhe emetimi për herë të parë i 2 miliardë lekë obligacionesh trevjeçare në muajin prill.

**Grafik 21. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).**



### III.3.3 Kredia për ekonominë

Teprica e kredisë është rritur mesatarisht me rreth 3.7 miliardë lekë në muaj, gjatë periudhës janar - maj 2005, duke shënuar në fund të periudhës një rritje në total prej 18.7 miliardë lekë. Ky nivel është i njëjtë me rritjen e kredisë gjatë gjithë vitit 2004. Zhvillimet pozitive të kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e të gjithë treguesve makroekonomikë të kredisë.


**Tabelë 16. Ecuria e disa treguesve kryesorë.**

	2002	2003	2004		2005
			6'M- I	6'M- II	Maj
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	458.2	507.2	533.2
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	69.5	68.9	69.4
- Kredi për qeverinë (% ndaj M3)	61.5	60.2	57.1	55.1	52.7
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	12.4	13.8	16.6
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	14.6	16.9	19.5
Kredi për ekonominë (% ndaj PBB)	5.7	6.8	7.4	9.0	10.9
Raporti kredi / depozita (në %)	13.5	15.7	16.7	19.0	22.0

Në terma vjetorë kredia për ekonominë, në fund të muajit maj shënoi një rritje 58 për qind. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së kredisë me afat maturimi mbi 1 vit, e cila ka kontribuar me rreth 79 për qind në rritjen totale. Gjithashtu, vihet re se pesha e kredisë afatgjatë në mënyrë të vazhdueshme ka fituar terren ndaj kredisë afatmesme, duke dëshmuar një angazhim në rritje të bankave drejt investimeve me afate të gjata maturimi.



**Grafik 22. Raporti i kredisë totale ndaj M3 (në përqindje) dhe rritja vjetore e kredisë totale (në përqindje, shkalla djathtas).**



Kontributin kryesor në rritjen e kredisë totale sipas monedhës vazhdon ta japë rritja e kredisë në valutë (me rreth 71 për qind), e cila përbën edhe 79 për qind të gjithë portofolit të kredisë. Si pasojë e forcimit të lekut ndaj euros dhe e nënçmimit të tij ndaj dollarit<sup>17</sup>, për periudhën janar – maj 2005, kredia në valutë është rritur me rreth 1.1 miliardë lekë.

Gjithsesi, gjatë pesë muajve të parë të vitit 2005, vihet re rritja e lartë vjetore që paraqet kredia në lekë,<sup>18</sup> e cila po jep një kontribut gjithmonë e më të madh në rritjen e kredisë në total. Ritmet pozitive të rritjes së kredisë në lekë në pjesën më të madhe të tyre, i dedikohen angazhimit në rritje të bankave për të ofruar shërbime në plotësimin e kërkesave për kredi të individëve (57 për qind). Ky fakt pasqyrohet në rritjen vjetore të lartë të kredisë për këtë grup, rreth 72 për qind. Në total kredia për individët përbën rreth 30 për qind të portofolit të kredisë.

**Tabelë 17. Tregues të tepricës së kredisë ndaj totalit (në përqindje).**

	2002	2003	T-1 '04	T-2 '04	T-3 '04	T-4 '04	Maj '05
Teprica e Kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	56.8	61.0	70.0	88.7
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	35.4	33.9	34.0	32.2
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	37.8	37.2	36.0	34.5
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	26.8	28.9	30.0	33.2
Kredi për individët	18.3	24.5	26.0	29.3	30.8	30.6	30.8
Kredi për sektorin privat	81.7	75.5	74	70.7	69.2	69.4	69.2
Lekë	21.3	19.6	17	17	17	19.5	21.0
Valutë	73.7	80.4	83	83	83	80.5	79.0

Pesë muajt e parë të vitit 2005 treguan preferencën në rënie të bankave për të kredituar sektorin e tregtisë, si dhe prirjet e tyre për të financuar me kredi sektorin e ndërtimit dhe blerjet për pasuri të paluajtshme.

<sup>17</sup> Për periudhën janar – maj 2005 leku është mbiçmuar me rreth 2 për qind kundrejt euros dhe është nënçmuar me rreth 8 për qind kundrejt dollarit.

<sup>18</sup> Në fund të muajit maj, teprica e kredisë në lek është dyfishuar në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

**Tabelë 18. Ecuria e tepricës së kredisë sipas degëve kryesorë të ekonomisë.**

	2002	2003	2004				2005
			T1	T2	T3	T4	Maj
1 Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	0.8	1.0	0.9	1.2	1.6	1.5	1.5
2 Industria Përpunuese	17.0	17.0	16.9	18.4	18.2	17.1	16.2
3 Ndërtimi	8.6	10.0	9.7	10.7	10.2	9.8	11.3
4 Tregtia, Riparimi i Automobilave dhe Artikujve Shtëpiake	40.4	34.0	31.4	23.5	21.9	23.3	18.9
5 Hotele dhe Restorante	6.0	6.0	7.1	8.3	8.3	8.3	5.0
6 Pasuritë e patundshme	9.1	13.0	13.7	14.8	15.6	9.8	14.3
7 Të tjera	18.1	19.0	20.3	23.1	24.2	30.2	32.8
Totali	100	100	100	100	100	100	100

Gjatë periudhës janar maj 2005 është akorduar rreth 42.3 miliardë lekë kredi e re ose 13.4 për qind më pak se sa gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Ky fakt dëshmon se rritja e tepricës së kredisë vjen kryesisht si pasojë e orientimit të bankave drejt investimeve me afate të gjata maturimi. Gjithashtu, në ndryshim nga një vit më parë, bankat janë angazhuar rreth 60 për qind më shumë në kredinë me afat maturimi mbi 1 vit, duke ulur ndjeshëm financimin e ekonomisë me kredi afatshkurtër.

Vetëm 30 për qind e kredisë së re është akorduar në lekë, kurse pjesa tjetër në monedhë të huaj. Kjo strukturë e kredidhënies ka mbetur pothuajse e pandryshuar krahasuar me një vit më parë.


Sipas shpërndarjes sektoriale të ekonomisë vihet re se sektori i tregtisë ka thithur rreth ¼ e kredisë së re të akorduar për gjithë periudhën. Gjithësesi, ky nivel është më pak se sa gjysma e kredisë akorduar këtij sektori një vit më parë. Ndërsa pjesa e tjetër e kredisë është thithur kryesisht nga sektorët prodhues (rreth 21%), sektori i ndërtimit (8.2%) dhe për pasuri të paluajtshme (12.2 %).

### III.4 TREGJET FINANCIARE DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

#### III.4.1 Ecuria e likuiditetit

Në gjysmën e parë të vitit 2005, sistemi bankar është karakterizuar nga një nivel i konsiderueshëm i likuiditetit të tepërt, i shkaktuar nga rritja e lartë e depozitave në lekë në muajt e parë të vitit. Niveli mesatar i likuiditetit të tepërt në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005, rezulton 7.9 miliardë lekë, krahasuar me 5.0 miliardë lekë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2004 dhe 5.2 miliardë lekë në gjashtëmujorin e dytë të tij.

**Grafik 23. Niveli ditor i likuiditetit të tepërt në sistemin bankar (në miliardë lekë).**




Rritja e likuiditetit të tepërt u vu re kryesisht në tremujorin e parë të vitit, kur përsëritet një rritje e dukshme e depozitave në lekë, si pasojë e kthimit të parasë jashtë bankave në sistem. Në fund të tremujorit të dytë, niveli i likuiditetit ra në vlera mesatare rreth 4.0 miliardë lekë. Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, tërheqja e likuiditetit të tepërt është kryer kryesisht me ankandet javore të repos me interes të përcaktuar, ndryshe nga një vit më parë, kur krahas këtij instrumenti, tërheqja e tij u realizua edhe me operacione strukturore (blerje me të drejta të plota dhe repo njëmujore). Niveli mesatar i investimit në repo njëjavore ka shënuar vlerën 6.2 miliardë lekë, krahasuar me 3.5 miliardë lekë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2004 dhe 3.1 miliardë lekë në gjashtëmujorin e dytë. Në një rast, është aplikuar dhe repo njëmujore.

Lehtësia e depozitës njëditore është përdorur rregullisht si mjet për investimin e likuiditetit. Mesatarisht, depozita njëditore ka regjistruar vlerën 0.67 miliardë lekë në gjashtëmujorin e parë 2005 ose 0.17 miliardë lekë dhe 0.18 miliardë lekë më pak se në gjashtëmujorin e parë dhe të dytë të vitit të kaluar. Kredia njëditore është përdorur rrallë dhe në shuma të vogla.

Nevojat afatshkurtra për likuiditet janë plotësuar në tregun ndërbankar, i cili mbizotërohet nga transaksionet njëditore. Në gjysmën e parë të vitit 2005, vëllimi i transaksioneve në këtë treg ka regjistruar rritje, krahasuar me vitin e kaluar. Niveli mesatar i huadhënies njëditore u rrit në 0.69 miliardë lekë, nga 0.48 miliardë lekë në gjashtëmujorin e parë 2004 dhe 0.37 miliardë lekë në gjashtëmujorin e dytë 2004. Mesatarja e huadhënies njëjavore rezultoi 0.49 miliardë lekë, nga 0.27 miliardë lekë në gjashtëmujorin e parë 2004 dhe 0.18 miliardë lekë në pjesën e dytë të këtij viti.

**Grafik 24. Vëllimi ditor i huadhënies në tregun ndërbankar (në milionë lekë).**



Tregu primar është karakterizuar nga rritja e kërkesës së bankave për të investuar në letra me vlerë të qeverisë. Shuma e ofruar nga bankat në tregun primar ka tejkaluar në çdo rast shumat e kërkuara nga qeveria. Për herë të parë, në muajin prill, u emetuan letra me vlerë me afat trevjeçar, kërkesë e cila u përballua nga sistemi bankar. Tregu i bonove të thesarit ka rezultuar me krijim të likuiditetit, pasi shumat e maturuara kanë qenë më të mëdha se investimet e reja, gjë që ka ushtruar presion për ulje të vazhdueshme të normave të interesit në këtë treg. Megjithatë, ulja e portofolit të bonove të thesarit me 5.3 miliardë lekë, në periudhën janar - qeshor, është kompensuar me rritjen e portofolit të obligacione dyvjeçare dhe trevjeçare në masën 10.8 miliardë lekë.

### III.4.2 Ecuria e normave të interesit


Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005, norma bazë e interesit arriti nivelet më të ulta historike prej 5.00 për qind. Krahasuar me vende të tjera, kjo normë interesi paraqitet si më poshtë.

**Tabelë 19. Normat bazë të interesit, korrik 2005 (në përqindje).**

Shqipëri	Eurozonë	SHBA
5.00	2.00	3.25

Gjatë gjashtëmuajorit të parë 2005, tregjet i janë përgjigjur politikës lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, duke ulur normat e interesit në tregun ndërbankar, në tregun e depozitave në lekë, në tregun e bonove të thesarit, në tregun e obligacioneve qeveritare dhe në tregun e kredive.

**Grafik 25. Ecuria e normave të interesit në lekë.**




Në fund të gjashtëmuajorit të parë, *yield*-i i bonove të thesarit dhe i obligacioneve qeveritare zbriti në nivelet më të ulta historike, ndërkohë që interesat e depozitave me afat në lekë, arritën nivelet më të ulta në 13 vitet e fundit. Megjithë luhatjet e interesave në tregun ndërbankar, sidomos në periudhën e mbajtjes së rezervës së detyrueshme, gjatë gjashtëmuajorit të parë 2005 ky treg evidentoi rënie të dukshme të normave të interesit duke kapur nivelet më të ulëta historike<sup>19</sup>.

Në tregun e kredive në lekë, i cili karakterizohet nga luhatje të mëdha të interesave nga njëri muaj në tjetrin, fundi i muajit maj 2005 rezultoi me ulje të interesave në të gjitha afatet, me përjashtim të kredive deri në gjashtë muaj. Në fakt, norma mesatare e ponderuar e kredisë në lekë ka shfaqur një prirje rënëse që prej muajit mars 2005. Në sjelljen e normave të interesit në këtë treg kanë ndikuar ulja e normës bazë të interesit, rritja e konkurrencës në sistemin bankar, shkalla e rrezikut të kredidhënies, ndryshimi i strukturës së kredidhënies nga njëri muaj në tjetrin, diferencat e mëdha midis interesave minimale dhe maksimale në tregun e kredive etj..

<sup>19</sup> Nivelet më të ulëta historike kanë qenë 2.36 për qind për huamarrjet njëditore (në fund të muajit maj) dhe 5.23 për qind për huamarrjet njëjavore (në mes të muajit qershor 2005).

**Grafik 26. Norma mesatare e ponderuar e kredisë në lekë (në përqindje).**



Sikurse shihet në tabelën e mëposhtme, normat e interesit në lekë janë ulur si në krahasim me fundin e vitit të kaluar dhe në krahasim me një vit më parë.


**Tabelë 20. Normat e interesit në lekë në muajin qershor 2005, ndryshimi 6-mujor dhe vjetor i tyre në pikë përqindjeje.**

	Qershor '05*	Ndryshimi me dhjetor '04	Ndryshimi me qershor '04
<b>Norma bazë e interesit</b>	<b>5.00</b>	<b>-0.75</b>	<b>-1.00</b>
Tregu ndërbankar o/n	2.50	-0.92	-0.77
Depozita 3-mujore	3.65	-0.83	-1.24
Depozita 6-mujore	4.41	-1.00	-1.69
Depozita 12-mujore	4.85	-1.14	-1.67
Yield-i i bonove të thesarit 3-mujor	5.06	-1.03	-1.76
Yield-i i bonove të thesarit 6-mujor	6.40	-0.82	-1.78
Yield-i i bonove të thesarit 12-mujor	6.79	-1.31	-2.21
Obligacionet 2- vjeçare	7.55	-1.45	-2.63
Kredi në lekë (interesi mesatar i ponderuar)	13.41	-0.30	-0.86

\* Të dhënat e depozitave dhe kredive në lekë i përkasin muajit maj 2005


Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2005<sup>20</sup>, interesat reale të depozitave 12 -mujore në lekë, u luhatën rreth nivelit mesatar prej 3.35 për qind, nga 3.75 për qind në gjashtëmujorin e dytë 2004. Ky nivel është ndikuar nga ulja e vazhdueshme e interesave nominalë dhe niveli i ulët i inflacionit gjatë kësaj periudhe.

**Grafik 27. Interesat realë për depozitat me afat 12 - mujor në lekë.**



Në tregun e depozitave në valutë, tendencat e normave të interesit në përgjithësi kanë qenë rritëse. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2005<sup>21</sup>, interesat nominalë të depozitave në usd janë rritur ndjeshëm në të gjitha afatet, ndërsa interesat e depozitave në euro kanë qenë në përgjithësi të qendrueshme.

**Grafik 28. Interesat mesatarë të ponderuara për depozitat me afat 12 - mujor në valutë.**



Në ecurinë e normave të interesit në valutë kanë ndikuar përkatësisht ecuria e interesave libor dhe euribor në tregjet ndërkombëtare, politika shtrënguese e FED-it dhe politika e pandryshuar e Bankës Qendrore Evropiane, si dhe rritja e konkurrencës në sistemin bankar.


**Tabelë 21. Normat e interesit të depozitave në valutë (në pikë përqindjeje).**

	Maj '05	Ndryshimi me dhjetor '04	Ndryshimi me qershor '04
<b>Usd</b>			
int. dep. 3 - mujore	2.07	+0.38	+1.32
int.dep. 6 - mujore	2.30	+0.42	+1.45
int. dep 12 - mujore	2.95	+0.68	+1.69
<b>Euro</b>			
int. dep. 3 - mujore	1.77	+0.02	+0.13
int.dep. 6 - mujore	1.81	+0.03	+0.14
int. dep 12 - mujore	1.94	-0.03	+0.14

Ulja e normave të interesit të depozitave në lekë dhe rritja e atyre në valutë kanë ndikuar në ngushtimin e *spread*-it midis tyre. Ky ngushtim i *spread*-eve ka reflektuar stabilitetin në treg, reagimin ndaj sinjaleve të politikës monetare, normën e ulët të inflacionit, si dhe forcimin e lekut në gjashtëmujorin e parë 2005.

<sup>21</sup> Të dhënat më të fundit janë deri në muajin maj 2005.

**Grafik 29. Spread-i midis interesave të depozitave lek-usd dhe lek-euro për afatet 12-mujore.**



Normat e interesit të kredisë në valutë kanë shfaqur prirje të kundërt për dy monedhat kryesore. Në fund të muajit maj, interesi mesatar i ponderuar i kredisë në usd është rritur në 8.39 për qind, krahasuar me 7.78 për qind në qershor 2004 dhe 7.79 për qind në fund të këtij viti. Ndërsa interesi mesatar i ponderuar i kredisë në euro ka zbritur në 7.89 për qind nga 8.62 për qind në muajin qershor 2004 dhe 8.17 për qind në fund të vitit.


Normat e interesit të kredive në valutë janë ndikuar kryesisht nga ecuria e tyre në tregjet ndërkombëtare, megjithatë, specifikat e tregut kredihënës në vend (konkurrenca, përqendrimi, rreziku etj.) kanë bërë që këto norma të jenë të luhatshme nga një muaj në tjetrin.

### III.5 ECURIA E KURSIT TË KEMBIMIT.

Vlera e monedhës vendase ndaj monedhave të huaja kryesore, euro dhe usd, është luhatur në intervale të ngushta. Gjatë periudhës janar-qershor, leku është mbiçmuar me 1.9 për qind kundrejt euros, ndërsa është nënçmuar me 10.9 për qind kundrejt dollarit. Megjithatë, kursi nominal efektiv i këmbimit, i cili merr parasysh peshat përkatëse të tregtisë me jashtë në euro dhe usd, tregon një mbiçmim të lehtë të lekut prej 0.6 për qind për këtë periudhë.

Faktorët themelorë që kanë ndikuar në mbiçmimin e lekut në dy vitet e fundit, kanë patur tendencë zbehjeje, ndërsa faktorët që ndikojnë mbi kursin e këmbimit në periudhën afatshkurtër, si rritja e ofertës së valutës nga turizmi apo remitancat, kanë balancuar efektin e kërkesës për mallra të importuara. Rritjet e ofertës valutore si dhe hyrja e prodhimit bujqësor vendas drejt fundit të gjashtëmujorit, kanë patur ndikime të përkohshme në ecurinë e kursit të këmbimit.

**Grafik 30. Ecuria e kursit të këmbimit gjatë vitit 2004 (lek/euro shkalla majtas).**



Gjithashtu, ecuria e kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj monedhave të huaja është subjekt i zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare të valutës. Ecuria e raportit euro/usd në tregun ndërkombëtar në favor të dollarit amerikan, është paqyruar kryesisht në nënçmim të lekut ndaj dollarit dhe në mbiçmim të lehtë ndaj euros në tregun vendas. Ky zhvillim është diktuar nga dominimi i ecurisë së dollarit amerikan në raportet e shumë prej valutave të ekonomive të mëdha në tregjet ndërkombëtare. Në përgjithësi, dollari amerikan është mbiçmuar kundrejt pjesës më të madhe të valutave të tjera të huaja, përfshi euron.

Në këto kushte, zhvillimet në tregun valutor vendas vlerësohet të kenë ndikuar pozitivisht në ruajtjen e ekuilibrave të kushteve të tregtisë me vendet partnere, në ekonominë e të cilave përdoret euro ose një monedhë tjetër që ka reflektuar mbiçmimin e dollarit amerikan.

Nivelet e këmbimit të lekut në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2005 janë 123.9 lek/euro dhe 102.8 lek/usd, kundrejt niveleve përkatësisht 126.4 lek/euro dhe 92.6 lek/usd në fillim të këtij viti.

## IV. ECURIA EKONOMIKE GJATË VITIT 2005.

Ecuria ekonomike gjatë gjysmës së parë të vitit tregon se linjat kryesore dhe parashikimet bazë të programit të zhvillimit ekonomik të vendit janë materializuar. Kështu, treguesit e parë të vitit sugjerojnë se ekonomia shqiptare ka patur rritje, ndërkohë që stabiliteti makroekonomik është konsoliduar më tej. Kështu, inflacioni i ulët gjatë pjesës së parë të vitit, kahu pozitiv i bilancit të pagesave, stabiliteti monetar i shprehur në raportet e qëndrueshme të agregatëve monetarë dhe të kursit të këmbimit, tregojnë se piketat kryesore të programit janë realizuar. Konsolidimi i vazhdueshëm i stabilitetit makroekonomik gjatë viteve të fundit, përbën një bazë të mirë për zhvillimin e ekonomisë shqiptarë në vitin 2005. Gjithashtu, ekonomia shqiptare është duke u mbështetur më shumë me kredi nga sistemi bankar, duke shfrytëzuar më mirë kapitalet financiare. Banka e Shqipërisë do të synojë të ruajë në ekonomi kushte monetare konsistente me objektivin e saj të inflacionit, duke synuar në të njëjtën kohë zhvillimin e tregut financiar dhe nxitjen e kreditimit të ekonomisë. Në përgjithësi, tabloja e parashikimeve makroekonomike për pjesën e mbetur të vitit nuk ka pësuar ndryshime me atë të fillimvitit. Ekonomia shqiptare parashikohet të rritet me 6 për qind gjatë vitit 2005, në prani të një inflacioni në intervalin 2-4 për qind.



**Tabelë 22. Treguesit kryesorë makroekonomikë.**

	2002	2003	2004	2005
<b>Treguesit monetarë (në përqindje)</b>				
Rritja e PBB-së	4.7	6.0	6.0	6.0
IÇK vjetor (mesatar)	5.2	2.4	2.9	3.0
PBB nominale (miliardë lekë)	630.0	695.1	780.1	857.3
<b>Sektori i jashtëm (në përqindje ndaj PBB-së)</b>				
Bilanci tregtar	-25.8	-24.8	-22.9	-22.2
Bilanci korent	-9.7	-8.2	-7.0	-7.0
<b>Treguesit fiskalë (në përqindje ndaj PBB-së)</b>				
Deficiti fiskal	-6.9	-4.7	-4.9	-4.9
Huamarrja e brendshme	3.2	2.7	1.9	2.7
<b>Treguesit monetarë (në përqindje)</b>				
Rritja M3	7.0	9.5	12.4	9.8
Rritja e kredisë për ekon.	32.1	28.5	31.3	47.1
Normat e interesit të bth 3m	11.2	7.3	6.1	...

Burimi: FMN, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë.

#### SEKTORI FISKAL

Buxheti fiskal i vitit 2005, parashikon një ecuri të moderuar të politikës fiskale, duke theksuar kontributin pozitiv të saj në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend. Gjatë vitit 2005, shpenzimet buxhetore planifikohet të arrijnë në 29 për qind të PBB-së, nga të cilat shpenzimet kapitale parashikohet të arrijnë në 5.9 për qind të PBB-së. Niveli i parashikuar i të ardhurave buxhetore është afërsisht i njëjtë me atë të vitit 2004, 24.1 për qind të PBB-së.

Kontributi i buxhetit të vitit 2005 në rrugën e konsolidimit fiskal qëndron në ruajtjen e deficitit buxhetor në nivelin 4.9 për qind të PBB-së. Pjesa kryesore e këtij deficiti do të përballohet me anë të financimit të brendshëm, i cili planifikohet të arrijë në rreth 2.7 për qind të PBB-së. Financimi i huamarrjes së brendshme të qeverisë nga sistemi bankar parashikohet në 15.7 miliardë lekë ose 1.8 për qind e PBB-së, ndërsa pjesa tjetër pritet të përballohet nga individët dhe subjektet e tjera private.

#### SEKTORI MONETAR

Objektivi kryesor i politikës monetare për vitin 2005, i përfshirë në programin monetar, mbetet ruajtja e normës vjetore të inflacionit në intervalin 2 – 4 për qind. Ky objektivi do të synohet të arrihet nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare në nivel të përafërt me rritjen e PBB-së nominale, nën supozimin e ecurisë së qëndrueshme të shpejtësisë së qarkullimit të parasë në ekonomi.

Kontrulli i agregatëve monetarë shërben si instrument i ndërmjetëm për kontrollin e inflacionit. Banka e Shqipërisë do të synojë të kontrollojë rritjen e ofertës monetare gjatë vitit 2005 në nivelin 9.8 për qind. Megjithë rënien e normave nominale të interesit në ekonomi, inflacioni i ulët ka ruajtur interesat realë në nivele stimuluese për futjen e parasë në sistem. Raporti i ulët i parasë jashtë bankave është rezultat i një tendence afatgjatë rënëse, karakteristike e periudhës së stabilizimit të një ekonomie. Si rezultat, pritet një ritëm më i ulët rritjeje për treguesin e parasë

jashtë bankave, norma e rritjes vjetore e të cilit parashikohet të zbresë në 4.8 për qind në fund të vitit 2005. Kthimi i pritshëm i parasë në sistem do të pasqyrohet në ruajtjen e ritmeve të kënaqshme të rritjes së depozitave në lekë. Norma vjetore e rritjes së tyre, në fund të vitit 2005, parashikohet të arrijë në 10.8 për qind, nga 10.6 për qind që ishte parashikimi i mëparshëm. Struktura valutore e ofertës monetare pritet të zhvendoset më tej drejt komponentit të saj valutor. Rritja e depozitave në valutë do të mbështetet në flukset e qëndrueshme valutore nga remitancat dhe në tendencën në rritje të interesave në dollarë. Bazuar në këtë supozim, norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë në fund të vitit 2005, parashikohet të rezultojë rreth 13.7 për qind.

Ekonomia shqiptare parashikohet të përfitojë kredi në masën 33.8 miliardë lekë gjatë vitit 2005. Në terma të PBB-së, teprica e kredisë për ekonominë parashikohet të rritet me rreth 3.9 pikë përqindjeje, kundrejt rritjes prej 2.5 për qind të PBB-së në vitin 2004. Teprica e kredisë në lekë parashikohet të rritet me rreth 12.2 miliardë lekë, duke përbërë rreth 36 për qind të rritjes së tepricës së kredisë gjithsej. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor për vitin 2005 është planifikuar në nivelin 23.3 miliardë lekë, nga të cilat sistemi bankar do të mbulojë 15.7 miliardë lekë, ose 1.8 për qind të PBB-së. Rritja më e ulët e pretendimeve neto të sistemit bankar ndaj qeverisë, krahasuar me kreditimin e ekonomisë tregon për një administrim më efektiv të fondeve të sistemit bankar. Rritja vjetore e mjeteve valutore neto të sistemit për vitin 2005 parashikohet 11.6 miliardë lekë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 67, datë 28.07.2005**

**PËR  
MIRATIMIN E DEKLARATËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË  
“ MBI STABILITETIN E SISTEMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI ”**

2.

Në mbështetje të nenit 69, pika 6 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë deklaratën e Bankës së Shqipërisë “**MBI STABILITETIN E SISTEMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI**” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me dërgimin e kësaj deklarate në Kuvendin e Shqipërisë, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**

**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**Deklaratë e Bankës së Shqipërisë**  
**“Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri”**

Në mbështetje të kërkesës së ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe detyrimit për të tërhequr vëmendjen e autoriteteve të vendit, të tregut financiar dhe të operatorëve të tij, si edhe të publikut, mbi rreziqet potenciale që kërcënojnë qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar, në vend, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë:

Banka e Shqipërisë nuk konstaton ndonjë element ose zhvillim, i cili të kërcënojë ecurinë e qëndrueshme të sistemit bankar dhe të sistemit financiar, në muajt e ardhshëm.

Megjithatë, si edhe më parë, Banka e Shqipërisë e shfrytëzon këtë mundësi që, krahas identifikimit të rreziqeve potenciale, të ngrejë edhe çështje të tjera që i shërbejnë mbarëvajtjes së sistemit bankar në veprimet e përditshme dhe që ndihmojnë në funksionimin më të mirë të sistemit financiar, në përgjithësi.

1. Banka e Shqipërisë konstaton se në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005, u evidentuan zhvillime pozitive në sistemin bankar, me përfitime të cilat janë ndjerë në një mënyrë më konkrete dhe në një shkallë më të lartë nga klientët e bankave dhe nga ekonomia në përgjithësi. Konkretisht:

- a) është zgjeruar kredia dhe janë pasuruar format e dhënies së saj për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut. Është realizuar një strukturim më i mirë i kredisë përse i takon afatit të maturimit. Cilësia aktuale e kredisë është e mirë dhe kushtet e dhënies së saj përfaqësojnë një bazë të shëndoshë për ruajtjen e kësaj cilësie edhe në të ardhmen;
- b) normat e interesit kanë ardhur në rënie, duke krijuar kushte më të përshtatshme që sistemi bankar dhe ai financiar në përgjithësi, të asistojnë më mirë zhvillimin ekonomik të vendit;
- c) sistemi i pagesave është konsoliduar më tej me zgjerimin e numrit të përdoruesve të kartave të debitit dhe të kreditit të lëshuara nga sistemi bankar, si edhe me finalizimin dhe vendosjen në funksionim të “Sistemit të Kryqëzimit të Pagesave me Vlerë të Vogël” nga Banka e Shqipërisë. Sistemi bankar, ka vijuar të zgjerohet në të gjithë vendin nëpërmjet hapjes së degëve dhe të agjencive të reja. Në fund të muajit qershor 2005, numri i degëve funksionale të sistemit bankar arriti në 110, ndërsa numri i agjencive funksionale të tij arriti në 108.

2. Gjatë periudhës së kaluar, u konsolidua më tej veprimtaria e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Rritja e fondit të sigurimit të depozitave që administrohet nga ky institucion, është shoqëruar me pasurim të mënyrave të investimit të tij. Në vijim të përvojës së deritanishme, Agjencia e Sigurimit të Depozitave synon të rishikojë kuadrin ligjor për të pasuruar instrumentet e saj në drejtim të njohjes më të afërt të situatës financiare në institucionet e siguruara, si edhe për të forcuar rolin e saj në faza të caktuara të veprimtarisë së tyre. Në zbatim të detyrimeve ligjore, Banka e Shqipërisë ka mbështetur nevojat e zhvillimit të këtij institucioni.

3. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005, u shënuan zhvillime të reja edhe në drejtim të pasurimit të mozaikut të institucioneve financiare. Përmendim rritjen e numrit të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, si edhe lindjen e fondeve të para jopublike të pensioneve. Këto zhvillime, të cilat pritet të vazhdojnë, duhet të shoqërohen me pasurimin dhe me konsolidimin e kuadrit rregullativ përkatës, si edhe me forcimin e funksionit mbikëqyrës të tyre.

Ndër treguesit kryesorë financiarë të sistemit bankar për periudhën e kaluar, përmendim:

Treguesi	dhjetor '04	maj '05
Mjaftueshmëria e kapitalit	21.63%	21.00% <sup>22</sup>
Kapitali aksioner (milionë lekë)	25,949.50	28,087.87
Rezultati neto (milionë lekë)	5,106.11	2,583.04
Kredia e re (milionë lekë)	99,726.57	42,298.00
Kredia me probleme neto / kredia neto	1.43%	0.95%
Kredia me probleme, bruto / totali i bilancit	0.69%	0.51%

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005, sistemi financiar në vend iu nënshtrua një vlerësimi profesional të posaçëm të kryer nga ekspertë të huaj, si pjesë e një programi global<sup>23</sup> të organizuar nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Vlerësimi nuk kufizohet vetëm në njohjen e gjendjes së sistemit financiar dhe në aftësinë e tij për të përballuar rreziqe të ndryshme dhe për t'u zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, por shtrihet edhe në aftësinë e autoriteteve për të mbikëqyrur këtë zhvillim në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Raporti përfundimtar ende nuk është publikuar, por rezultatet paprapake të këtij vlerësimi për sistemin bankar dhe autoritetin mbikëqyrës të tij, janë pozitive. Rekomandimet e këtij raporti, do të jenë pjesë e planit të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit bankar, në të ardhmen e afërt.

<sup>22</sup> Në fundin e muajit mars 2005.

<sup>23</sup> Në anglisht, ky vlerësim njihet me termin "Financial Sector Assessment Program" (FSAP).

Pavarësisht nga sa më sipër, Banka e Shqipërisë tërheq vëmendjen në çështjet e mëposhtme, të cilat kërkojnë një vlerësim më të madh dhe të vazhdueshëm, nga të gjithë aktorët e sistemit bankar.

Rritja e kreditimit me ritme të përshpejtuara në kushtet e forcimit të konkurrencës në treg, e vendos sistemin bankar përballë rrezikut real të përkeqësimit të cilësisë së saj, nëse ulet vëmendja ndaj respektimit rigoroz të kërkesave për identifikimin e huamarrësve të mirë, të cilët sigurojnë të ardhura të qëndrueshme nga veprimtaria e kredituar. Krahas zbatimit të procedurave për miratimin e kredisë, bankat duhet të vënë në funksionim sa më të shpejtë, strukturat përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Është e nevojshme gjithashtu, që bankat të tregohen konservatore në provigjonimin e kredisë, në shenjat më të para të vështirësisë së huamarrësit për shlyerjen e saj. Në këtë mënyrë, çdo bankë dhe sistemi në tërësi, do të shmangë thellimin e problemeve që mund të vijnë nga përkeqësimi i cilësisë së kredisë, duke siguruar një qëndrueshmëri më të mirë të rezultatit financiar. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë është e vendosur të vërë në funksionim, në një kohë sa më shpejtë, Zyrën e Informacionit të Kredive, duke synuar të përfitojë në këtë rast edhe asistencën e institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në kushtet e rritjes së konkurrencës, është vërejtur një rritje e qarkullimit të personelit, veçanërisht atij me përvojë dhe aftësi të spikatura profesionale, drejt bankave dhe institucioneve të tjera financiare që ofrojnë kushte më të mira pune. Megjithëse ky është një zhvillim i natyrshëm, Banka e Shqipërisë kërkon nga të gjitha bankat të bëjnë përpjekjet maksimale për të nxitur më mirë dhe për të ruajtur personelin e tyre. Objektivi për t'i siguruar kushte më të mira pune personelit të institucionit, nuk kufizohet vetëm në shpërblimin material sipas performancës në punë, por shtrihet edhe në mundësitë që krijon institucioni për trainim dhe ngritje profesionale, për nxitje nëpërmjet zhvillimit në karrierë, për përfitime të ndryshme sociale etj.. Nëse këto mundësi nuk do të shfrytëzohen në maksimum, banka të veçanta rrezikojnë të provojnë rritje të kostos së veprimtarisë së tyre dhe ulje të cilësisë së shërbimit për publikun, me ndikim negativ të ndjeshëm në ruajtjen e pozicionit të tregut dhe në rezultatin e tyre financiar. Nga ana e Bankës së Shqipërisë, lëvizjet e konsiderueshme të personelit në kushtet e mungesës së përpjekjeve reale të drejtimit të bankës për ta motivuar atë, do të konsiderohen si paaftësi e drejtimit dhe do të ndikojnë në vlerësimin e përgjithshëm të bankës.

Është e rëndësishme që të ekzistojë një komunikim i hapur dhe i vazhdueshëm mes aktorëve më të rëndësishëm të tregut bankar dhe autoritetit monetar dhe mbikëqyrës. Brenda përgjegjësive respektive ligjore dhe të vetëdijshme për rolin që luajnë, palët duhet të sigurojnë që ky komunikim t'i shërbejë diskutimit konstruktiv të pikëpamjeve respektive, në drejtim të zbatimit të politikës monetare dhe të kuadrit rregullativ e mbikëqyrës. Në këtë mënyrë, do të arrihej një ekuilibër më i mirë mes interesit të autoritetit monetar dhe mbikëqyrës nga njëra anë, dhe aktorëve të rëndësishëm të

sistemit bankar nga ana tjetër, duke mënjeluar lëvizje të njëanshme dhe të kushtueshme në politikat dhe në instrumentet që përdorin të dyja palët, për të sinjalizuar objektivat e ardhshëm të veprimtarisë së tyre.

Pjesa e dytë e këtij viti, përfaqëson periudhën kur duhet të përfundojë rishikimi i ligjit ekzistues nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Projekti do t'i nënshtrohet një diskutimi të gjerë me industrinë bankare dhe me të gjitha institucionet e tjera që kanë rol në zhvillimin e tregut financiar. Projekti është hartuar me asistencën e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe përmban praktikën më të mirë ndërkombëtare në fushën e zhvillimit dhe të mbikëqyrjes së sistemeve bankare. Banka e Shqipërisë kërkon mbështetjen e institucionit të Qeverisë dhe të Kuvendit, që ky projekt të shqyrtohet dhe të miratohet brenda vitit 2005.

Fillimi i vitit të ardhshëm, përfaqëson periudhën kur me ligj parashikohet hyrja në fuqi dhe zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit / Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, edhe për bankat e nivelit të dytë. Banka e Shqipërisë, e shfrytëzon edhe një herë këtë deklaratë për të kërkuar nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, të cilat kanë rol në zbatimin në praktikë të standardeve të përmendura më sipër, të ndërtojnë një strategji të qartë për mënyrën se si do të realizojnë këtë rol dhe objektivat e tyre. Banka e Shqipërisë thekson se është i nevojshëm të institucionalizohet një proces i përbashkët diskutimi, ku institucionet të diskutojnë problemet që do të dalin në fazën përgatitore dhe në zbatimin e këtyre standardeve, në mënyrë që problemet të kuptohen dhe qëndrimi ndaj zgjidhjeve të tyre të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm në kohë.

Banka e Shqipërisë beson se periudha deri në fund të vitit 2005, do të vijojë të dëshmojë normalitet në veprimtarinë e sistemit bankar dhe financiar, në ecurinë e vazhdueshme drejt konsolidimit dhe qëndrueshmërisë së tij.

3.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr.68, datë 28.07.2005**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43, gërma “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, sipas teksit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve Publike në Bankën e Shqipërisë për botimin e kësaj rregulloreje në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**Ylli Memisha**

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**



## RREGULLORE

### “PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR”

#### Neni 1

##### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

#### Neni 2

##### **Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje, janë të gjitha subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi dhe në vazhdim do të quhen “shoqëri”, që kanë në pronësi filiale dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera të licencuara ose jo nga Banka e Shqipërisë, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 3

##### **Qëllimi i mbikëqyrjes së konsoliduar**

Mbikëqyrja e konsoliduar vlerëson pozicionin ndaj rrezikut/rreziqeve jo vetëm të veprimtarisë së vet shoqërisë, por edhe të veprimtarisë së filialeve dhe të pjesëmarrjeve të saj.

#### Neni 4

##### **Përcaktime**

Për plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptimin që vijon:

1. **Shoqëria konsoliduese dhe/ose shoqëria - mëmë** quhet subjekti që ka në pronësi filiale dhe pjesëmarrje në shoqëritë e tjera.
2. **Shoqëri të konsoliduara** quhen filialet dhe pjesëmarrjet e shoqërisë konsoliduese.
3. **Grupi i konsoliduar** përbëhet nga shoqëria konsoliduese dhe shoqëritë e konsoliduara.
4. **Filiali** ka të njëjtin kuptim me nenin 2, pika 1, gërma g, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit ky term

“nënkupton çdo person juridik në të cilin një subjekt tjetër ose persona juridikë të lidhur, zotërojnë më shumë se pesëdhjetë për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote, duke e lejuar këtë subjekt ose personat juridikë të lidhur të ushtrojnë kontroll mbi të”.

5. **Pjesëmarrje** ka të njëtin kuptim me nenin 2, pika 1, gërma ë, të ligji nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit ky term “nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të së drejtës së pronësisë së një aksioneri në masën dhjetë për qind ose më shumë të kapitalit të personit juridik ose të aksioneve të tij me të drejtë vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin dhe politikën e personit juridik”.

### **Neni 5**

#### **Struktura e mbikëqyrjes së konsoliduar**

Mbikëqyrja e konsoliduar përbëhet nga :

1. Kontabiliteti i konsoliduar.
2. Mbikëqyrja sasiore.
3. Mbikëqyrja cilësore.

### **Neni 6**

#### **Kontabiliteti i konsoliduar**

1. Qëllimi i kontabilitetit të konsoliduar është pasqyrimi i gjendjes financiare të grupit të konsoliduar.
2. Organizimi i kontabilitetit të konsoliduar bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS 27, 28, 30, 31, 32, 39) dhe të Manualit të Kontabilitetit Bankar.

### **Neni 7**

#### **Mbikëqyrja sasiore**

Mbikëqyrja sasiore është respektimi i kuadrit rregullator të mbikëqyrjes së konsoliduar, i cili përbëhet nga :

1. Kapitali rregullator në përputhje me udhëzimin “Për kapitalin rregullator”, formulari i të cilit, për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar, zëvendësohet me formularin bashkëngjitur.

2. Mjaftueshmëria e kapitalit sipas rregullores “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”.
3. Shpërndarja e rrezikut sipas rregullores “Për kontrollin e rreziqeve të mëdha”.
4. Marrëdhëniet me personat e lidhur sipas rregullores “Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të”.
5. Mbulimi i rreziqeve të tregut sipas rregullores “Për rreziqet e tregut”.

### **Neni 8** **Mbikëqyrja cilësore**

Mbikëqyrja cilësore përqëndrohet në analizën e cilësisë mbi baza të konsoliduara, kryesisht të:

1. Organizimit të kontrollit të brendshëm dhe drejtimit të rrezikut/rreziqeve.
2. Strukturës drejtuese dhe strukturës organizative.
3. Vlerësimit të rrezikut operacional, strategjik, reputacional dhe ligjor.
4. Vlerësimit të rrezikut sistemik në perspektivë.
5. Strategjisë së veprimtarive të brendshme ndërmjet shoqërisë konsoliduese dhe shoqërive të konsoliduara.
6. Mjaftueshmërisë së informacionit.
7. Vlerësimit të drejtimit sipas politikave të brendshme dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë.

### **Neni 9** **Bashkëpunimi në kuadër të mbikëqyrjes së konsoliduar**

1. Krijimi i cilësisë së mbikëqyrjes së konsoliduar realizohet duke lidhur marrëveshje reciproke bashkëpunimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve mbikëqyrëse dhe rregullative të njësive përbërëse të grupit të konsoliduar, brenda dhe jashtë vendit.
2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t’i kërkojë dhe t’i dërgojë raporte, të dhëna dhe informacion, autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të tjera, nëse ato janë të

nevojshme për mbikëqyrjen e konsoliduar mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, të nënshkruara midis palëve.

3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kryejë inspektime në vend dhe/ose të marrë informacion në kuadër të bashkëpunimit për mbikëqyrjen e konsoliduar, për të kontrolluar vërtetësinë e raporteve dhe të të dhënave për mbikëqyrjen e konsoliduar.

### **Neni 10** **Raportimi**

1. Shoqëritë konsoliduese përgatisin dhe vërtetojnë pranë auditorëve të jashtëm, pasqyrat financiare të konsoliduara. Këto pasqyra raportohen në Bankën e Shqipërisë brenda afateve ligjore, në fund të çdo viti financiar.
2. Shoqëritë përgatisin raportet vjetore të publikueshme mbi baza të konsoliduara (grupit të konsoliduar).
3. Në raportet vjetore të publikueshme, shoqëritë publikojnë listën e filialeve dhe të pjesëmarrjeve, të cilat janë përfshirë në pasqyrat e konsoliduara. Gjithashtu, në raportet vjetore përfshihet edhe lista e pjesëmarrjeve të cilat nuk janë konsoliduar, e shoqëruar me shënimet përkatëse.
4. Në zbatim të nenit 7 të kësaj rregulloreje, raportimet bëhen sipas përcaktimeve në aktet rregullative përkatëse.
5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë për shoqëritë konsoliduese dhe/ose të konsoliduara.

### **Neni 11** **Dispozitë përfundimtare**

Kjo rregullore është miratuar me vendim nr.68, datë 28.07.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës**

**Ardian Fullani**

**FORMULARI I RAPORTIMIT**  
**(kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë)**

Emri i grupit bankar të konsoliduar ....  
 Periudha raportuese .....  
 Data e raportimit .....  
 Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë)  
 Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)

në mijë Lekë.

	<b>KAPITALI BAZË</b>	Nr.llog.		Shuma
	<b>I . Elementet përbërëse që shtohen (A) :</b>			
1	Kapitali i nënshkruar	5711		
2	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	5731,5733,5734		
3	Primet e emetimit dhe të fuzionimit	572		
4	Fitimet e pashpërndara (e bartura)	577(P)		
5	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	578(P)		
6	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	578(P)		
7	Diferenca rivlerësimi kreditore (pozitive)	574(P)		
8	<b>Diferencat e konsolidimit kreditore (pozitive)</b>			
9	<b>Interesat pjesëmarrës të pakicës</b>			
	<b>Nëntotali A= ( 1+2+3+4+5+6+7+8+9 )</b>		A	
	<b>II . Elementet përbërëse që zbriten (B) :</b>			
1	Kapitali i nënshkruar i papaguar	5712		
2	Vlera nominale e aksioneve (të pashitura , të riblera)			
3	Humbjet e pashpërndara ( të bartura )	577(-P)		
4	Humbja ushtrimore	578(-P)		
5	Diferenca rivlerësimi debitore (negative)	574(-P)		
6	Aktive <sup>1</sup> të qëndrueshme të patrupëzuara	531		
7	<b>Diferencat e konsolidimit debitore (negative)</b>			
	<b>Nëntotali B= ( 1+2+3+4+5+6+7 )</b>		B	

<sup>1</sup> Sipas Manualit të Kontabilitetit Bankar duhet të zëvendësohet me fjalën "mjete".

	Totali i kapitalit bazë $C = (A - B)$		C	
	<b>KAPITALI SHITESË</b>			
	<b>III . Elementet përbërëse (J) :</b>			
1	Rezervat e rivlerësimit	5732	EA	
2	Rezerva të përgjithshme		EB	
3	Istrumente hibride	56	EC	
4	Detyrime të varura me afat	56	F	
	Në qoftë se $F \leq C/2$ atëherë $G = F$		G	
	Në qoftë se $F > C/2$ atëherë $G = C/2$		G	
	Nëntotali i kufizuar $H = (EA + EB + EC + G) :$		H	
	Kufizimi i parë: në qoftë se $H \leq C$ atëherë $J = H$		J	
	Kufizimi i dytë: në qoftë se $H > C$ atëherë $J = C$		J	
	Totali i kapitalit shtesë para zbritjes (J)		J	
	<b>IV . Elementet përbërëse që zbriten (P +Q+V) :</b>			
<b>1</b>	<b>Interesat pjesëmarrëse (P):</b>			
--	Në shoqëritë jofinanciare të konsoliduara sipas metodës së kapitalit.		K	
--	Në shoqëritë financiare dhe jofinanciare të përjashtuara nga perimetri i konsolidimit.		L	
	Nëntotali $P = (K + N)$		P	
2	Garancitë e dhëna fondeve të garancive reciproke sipas kushteve të bankës qendrore.		Q	
3	Aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë (V) :			
--	rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin nr.13, datë 21.02.01 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		V1	
--	rregullorja "Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e lejuara të bankave dhe të degëve të bankave të huaja të licencuara", miratuar me vendimin nr.51, datë 22.04.99 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		V2	
--	akte të tjera rregullative.		Vn	
	totali i akteve rregullative : $V = (V1 + V2 + Vn)$		V	

	Nëntotali i pjesës që zbritet është $(P+Q+V)$		<b>P+Q+V</b>	
	<b>Llogaritja përmbledhëse e kapitalit bazë dhe e kapitalit shtesë pas zbritjes IV :</b>			
1	Në qoftë se $J \leq (P+Q+V)$ atëherë :			
--	Kapitali shtesë pas zbritjes $JA = 0$		JA	
--	Kapitali bazë $CA = C + J - (P+Q+V)$		CA	
2	Në qoftë se $J > (P+Q)$ atëherë :			
--	Kapitali shtesë pas zbritjes $JA = J - (P+Q+V)$		JA	
--	Kapitali bazë $CA = C$		CA	
	<b>Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë :</b> <b><math>E = (JA+CA)</math></b>		<b>E</b>	

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004".
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë"".
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 "Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave".
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë".
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë".
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 "Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes".
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.".
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë".
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 "Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë".



Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 “Për miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2005”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005

2. Vendim nr.18, datë 09.03.2005 “Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005”.
3. Vendim nr.19, datë 09.03.2005 “Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë”.
4. Vendim nr.22, datë 09.03.2005 “Për lirimimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 “Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë”.
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 “Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006”.
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 “Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 “Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005”.
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 “Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 “Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.

4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".

6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".
7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin maj të vitit 2005"".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)"".
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS"".
6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIP

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005

1. Vendim nr. 56, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi transaksionet e shitbjeve me të drejta të plota"".
2. Vendim nr. 57, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë Lombard"".
3. Vendim nr.58, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për depozitën njëditore"".
4. Vendim nr. 59, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë njëditore"".

5. Vendim nr. 60, datë 13.07.2005 “Për vendosje komisioni në sportelet e Bankës së Shqipërisë për bonot e thesarit”.